



sondazh i opinionit publik

2018
BESIMI NË QEVERISJE



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Sondazh i opinionit publik

BESIMI në QEVERISJE 2018

Raporti i sondazhit



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Sondazh i opinionit publik 2018: Besimi në qeverisje
Raporti i sondazhit

Autorë:

Aleka Papa
Leonie Vrugtman

Koordinatori i punës në terren:

Besjana Kuçi

Përkthimi nga anglishtja:

Durim Tabaku

© 2019 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1 1017
Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@idmalbania.org
Web: www.idmalbania.org

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) ose të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Besimi në qeverisje 2018 - përmbledhje

Besimi në institucione

- Krahasuar me një vit më parë, në 2018 shtatë institucione regjistruan një rritje të besimit në përgjithësi, dy institucione kanë mbetur në vend, ndërsa nëntë të tjera kanë pasur një rënie të nivelit të përgjithshëm të besimit. Institucionet fetare (73%) janë institucionet më të besuara në Shqipëri për vitin 2018, ndërsa partitë politike janë më pak të besuarat (22%). Për herë të parë që nga viti 2016, organizatat ndërkombëtare (BE, OKB, dhe NATO) kanë shënuar një rënie të besimit publik.
- Institucionet që marrin vlerësime pozitive të besimit nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë: sistemi arsimor (64%), forcat e armatosura (63%), policia e shtetit (58%), organizatat e shoqërisë civile (57%), media (56%) dhe sistemi shëndetësor (54%).
- Qeveria qendrore gëzon nivel më të lartë besimi tek të anketuarit nga bashkitë e mesme (50,000-100,000 banorë/bashki) sesa tek të anketuarit nga bashkitë e vogla (>50,000 banorë) apo të mëdha (mbi 100,000 banorë). Të anketuarit nga bashkitë e mëdha tregojnë nivelin më të ulët të besimit tek policia, media dhe institucionet fetare. Për BE-në, OKB-në dhe NATO-në tregohet më shumë besim nga të anketuarit në bashkitë e mëdha dhe më pak në bashkitë e vogla.
- Për sa i përket reformës në drejtësi, si pritshmëritë pozitive publike për ndikimin e saj ashtu edhe besimi se kjo reformë po zbatohet siç duhet kanë humbur vazhdimisht terren në tre vitet e fundit. 53% e të intervistuarve besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv, ndërsa vetëm 35% thonë kjo reformë po zbatohet siç duhet – me rënie prej 8 pikë përqindje (p.p.) nga 2017 dhe 11 p.p nga 2016.
- Ndonëse 56% e të anketuarve besojnë tek media në 2018, besueshmëria e perceptuar e raportimit të medias ka rënë me 8 pikë përqindje në tre vitet e fundit. Vetëm 42% besojnë se informacioni i dhënë nga mediat është i saktë dhe i vërtetë dhe më shumë se një e treta ose 34% kanë mendim të kundërt.
- Kur pyeten nëse do të largoheshin nga vendbanimi aktual, 55% thanë “po”. Nga kjo përqindje, 47% do të donin të largoheshin nga Shqipëria, ndërsa vetëm 8% brenda vendit.
- Tendenca për t’u larguar ka lidhje të drejtpërdrejtë me nivelin arsimor. 36% e të anketuarve me arsim bazë do të largoheshin nga Shqipëria, krahasuar me 53% e atyre me arsim universitar.

Transparenca dhe llogaridhënia

- Shumica e të anketuarve mendojnë se si niveli vendor i qeverisjes ashtu edhe qeveria qendrore kanë në përgjithësi mungesë të transparencës dhe llogaridhënies; vlerësimet pozitive për to nuk i kalojnë 40% të të anketuarve.
- Të anketuarit priren ta konsiderojnë pushtetin vendor si më transparent dhe llogaridhënës krahasuar me qeverinë qendrore.
- Të intervistuarit nga bashkitë e mëdha kanë një mendim më pozitiv për transparencën e bashkisë së tyre sesa ata nga bashkitë e mesme apo të vogla.
- Për të tretin vit radhazi, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mendohet se ka rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (61%), ndjekur nga media (me 58%).
- Në 2018, krahasuar me 2017, të gjitha institucionet mendohet se kanë një rol në rënie për sa i përket kërkesës së llogarisë ndaj qeverisë dhe ku rënia më e madhe lidhet me rolin e partive të opozitës (me rënie prej 11 p.p.) pasuar nga Kuvendi (me rënie prej 9 p.p.).

Korrupsioni në institucionet publike

- Më shumë se 8 në 10 të anketuar e perceptojnë si korrupsionin e nivelit të ulët ashtu edhe atë të nivelit të lartë si të përhapur në shoqërinë shqiptare për vitin 2018. Krahasuar me 2017, nuk ka ndryshime për sa i përket nivelit të perceptimit.
- Të anketuarit kanë më pak besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit, duke konfirmuar kështu nivelin e ulët të besimit në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, të anketuarit kanë më pak besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë krahasuar me ato të korrupsionit të nivelit të ulët.
- 21% e të anketuarve në vitin 2018 kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast korrupsioni në nivelin e qeverisjes vendore, ndërsa rreth 14% kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast korrupsioni në qeverinë qendrore. Krahasuar me 2017, nuk ka ndryshime për sa i përket numrit të rasteve si dëshmitarë të rasteve të korrupsionit.
- Nga ata që kanë marrë shërbime gjatë vitit 2018, 30% kanë paguar ryshfet në nivel vendor, ndërsa 24% në nivel qendror. Krahasuar me 2017, ka një rënie në numrin e rasteve të raportuara të ryshfetit, veçanërisht në nivel qendror. Pjesa më e madhe e të anketuarve që kanë paguar ryshfet, nuk e kanë raportuar atë. Kur u pyetën për arsyet pse nuk i kanë raportuar, 47% prej tyre thanë se është e kotë të raportosh.

Ndikimi politik

- Institucionet fetare perceptohen si më të pavarurit nga ndikimi politik gjatë 2018; ky pohim mbështetet nga 67% e të anketuarve. Nga ana tjetër, prokuroria dhe gjykatat perceptohen si institucionet më pak të pavarura nga ndikimi politik. Vetëm 13% dhe 14% e të anketuarve i perceptojnë interesat politike si pa ndikim në punën e prokurorisë dhe gjykatave.

Angazhimi qytetar

- 57% e të anketuarve janë të interesuar të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike.
- 40% e të anketuarve raportojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel vendor dhe 31% e të anketuarve raportojnë se e kanë këtë mundësi në nivel qendror.
- Në 2018, njësitë e qeverisjes vendore marrin më shumë pikë se qeveria qendrore për sa i përket ofrimit të mundësive për konsultime dhe nivelit të pjesëmarrjes në konsultim. 8% e të anketuarve kanë marrë pjesë në një proces konsultimi në nivel qendror, ndërsa 19% raportuan të kenë marrë pjesë në një takim konsultimi në nivel vendor.
- Gjithsesi, skepticizmi për proceset konsultuese ende vazhdon. 39% e të anketuarve që u ftuan për të marrë pjesë në një takim konsultimi e refuzuan ftesën, sepse nuk besojnë në procese të tilla.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve (62%) raportojnë se buxheti i bashkisë nuk pasqyron prioritetet e njerëzve.
- 23% e të anketuarve kanë ndjekur një tubim/demonstratë apo kanë nënshkruar një peticion në 2018. 67% e të anketuarve kanë dëshirë të bëjnë punë vullnetare në të mirë të komunitetit.

Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

- Në përgjithësi, sipas qytetarëve shqiptarë ofrimi i shërbimeve publike nuk është i kënaqshëm. Të anketuarit, pavarësisht nëse i kishin përdorur shërbimet apo jo në 2018, janë veçanërisht të pakënaqur me shërbimin e punësimit (74%), shërbimet e drejtësisë (62%), shërbimet sociale (59%), transportin publik (57%) dhe sistemin e kujdesit shëndetësor (57).
- Të anketuarit që kishin marrë shërbime publike në 2018 kishin më shumë gjasa të raportonin se ishin të kënaqur me transportin publik, shërbimet e mirëqenies sociale, shërbimin e pastrimit të rrugëve dhe furnizimin me ujë.

- 56% e të anketuarve nuk shohin ndryshime në shërbimet sociale të ofruara nga bashkitë. Në bashkitë e vogla niveli i pakënaqësisë është më i lartë se ai në bashkitë e tjera për shërbimin shëndetësor, regjistrimin e pronave dhe mjedisin e biznesit.
- Vetëm 11% e të anketuarve kishin bërë ankesë tek institucionet publike për një shërbim të marrë gjatë 2018. 10% e të anketuarve kishin bërë një ankesë në platformën e bashkëqeverisjes.
- 46% e të anketuarve raportojnë se institucionet nuk i marrin parasysh ankesat e qytetarëve dhe se nuk i trajtojnë siç duhet ato. Nga ata të anketuar që kishin bërë ankesë, 50% thanë se ankesa e tyre ishte trajtuar, duke treguar një rritje në krahasim me vitet e mëparshme.
- Shumica e të anketuarve (59%) ndjehen të pasigurt në jetën e përditshme. Faktorët e cituar më shpesh që shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë janë kriminaliteti, pasiguria e punës dhe problemet e kujdesit shëndetësor.

Performanca e institucioneve publike

- Të anketuarit në përgjithësi kanë kritika për performancën e institucioneve publike. Në mënyrë të veçantë, morën vlerësim negativ gjykatat (66%), prokuroria (64%) dhe Parlamenti (59%).
- Institucionet me performancën më të mirë ishin institucionet fetare (43% shkëlqyeshëm/shumë mirë), ushtria (34% shkëlqyeshëm/shumë mirë) dhe policia (30% shkëlqyeshëm/shumë mirë).
- Të anketuarit nga qendrat kryesore urbane – bashkitë e mëdha me mbi 100,000 banorë për bashki – janë në përqindje më të madhe me opinion pozitiv për performancën e institucioneve gjatë 2018. Të anketuarit në bashkitë e vogla janë më shumë kritikë për performancën e qeverisë qendrore, prokurorisë, gjykatave, policisë, institucioneve fetare dhe ushtrisë.

TIK (Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit)

- Vetëm 38% e të anketuarve janë në dijeni që bashkia e tyre ka një faqe interneti. 53% u përgjigjën se nuk e dinë nëse bashkia e tyre ka faqe interneti dhe 9% besojnë se bashkia e tyre nuk ka faqe interneti.
- Pjesa më e madhe e të anketuarve e përdorin faqen e internetit të bashkisë së tyre për të marrë informacione për ngjarje apo programe ose për të kontrolluar për shërbimet që ofrohen për ta.
- Faqja e internetit e bashkisë vlerësohet si e saktë (87%), përditësohet vazhdimisht (69%) dhe e pasur me informacione (62%).

- 54% e të anketuarve kanë dijeni për e-Albania, portali i Shqipërisë për shërbimet të e-qeverisjes.
- Të anketuarit që kanë përdorur portalin e-Albania për të marrë shërbime elektronike e konsiderojnë atë funksionale (94%) dhe të lehtë për t'u përdorur (76%).

Gjinia dhe përfshirja sociale

- 55% e të anketuarve besojnë se në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave. 69% e të anketuarve raportojnë se në Shqipëri gratë dhe burrat kanë të njëjtin akses tek shërbimet publike dhe se nëpunësit publikë u shërbejnë grave dhe burrave me të njëjtin përkushtim dhe etikë.
- Gratë kanë më pak gjasa që të jenë dakord me këto pohime në krahasim me burrat. Nga ana tjetër, të anketuarit që banojnë në zonat rurale raportojnë më shpesh se ka barazi gjinore në krahasim me të anketuarit që jetojnë në zonat urbane.
- 16% e të anketuarve raportojnë se janë trajtuar ndryshe nga institucionet publike në bazë të karakteristikave të tyre, si gjinia, mosha, etnia, apo orientimi seksual.
- 80% e të anketuarve mendojnë se gratë janë po aq të afta sa burrat që kanë poste publike. Gratë (85%) ishin dakord me këtë pohim më shumë se burrat (75%).
- 70% e të anketuarve shprehen se rritja e numrit të grave në këshillin bashkiak do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore.

Tabela e përmbajtjes

1.Hyrje	10
2. Metodologjia	11
2.1 Qasja	11
2.2 Kufizimet	12
3. Demografia e kampionit	13
4. Rezultatet e sondazhit të opinionit	31
4.1 Besimi në institucione	42
4.2 Transparenca dhe llogaridhënia	49
4.3 Korrupsioni në institucionet publike	51
4.4 Ndikimi politik	62
4.5 Angazhimi qytetar	72
4.6 Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike	74
4.7 Performanca e institucioneve publike	80
4.8 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	58
4.9 Gjinia dhe përfshirja sociale	96
Lista e tabelave dhe grafikëve	75
Bibliografia	78
Shtojcat	80
Shtojca 1: Njësitë administrative	80
Shtojca 2: Karakteristikat e kampionit 2013-2018	82

1. Hyrje

Në këtë raport paraqiten gjetjet e Sondazhit Publik “Besimi në Qeverisje” të kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë periudhës 8-22 nëntor 2018 në të 61 bashkitë e Shqipërisë. Ky është viti i gjashtë radhazi që kryhet ky sondazh publik (2013-2018) ku është përdorur një metodologji, pyetësor dhe mbulim kombëtar i ngjashëm.

Sondazhi publik përfaqëson një instrument që bën të mundur monitorimin çdo vit të besimit publik dhe perceptimet për qeverisjen si dhe angazhimin e qytetarëve në Shqipëri. Ai ka si objektiv kryesor të shqyrtojë perceptimet dhe qëndrimet e publikut për çështje që kanë të bëjnë me: besimin në institucione, transparencën dhe llogaridhënien, korrupsionin, nivelin e angazhimit të qytetarëve në politikëbërje dhe vendimmarrje, kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike, dhe zbatimin e politikave dhe ligjeve anti-diskriminuese. Po ashtu, sondazhi publik prodhon të dhëna që kontribuojnë në përmirësimin e reformave madhore që lidhen me qeverisjen e mirë, anti-korrupsionin, reformën në gjyqësor dhe çështje që prekin të gjithë sektorët, si barazia gjinore dhe përfshirja sociale. Ky raport shërben për të çuar më tej progresin e Shqipërisë në përmbushjen e angazhimeve të tjera kombëtare e ndërkombëtare, si Partneriteti për Qeverisjen e Hapur dhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (të fokusuar kryesisht tek treguesit e Objektivit 16 “Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësinë për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”).

Raporti nis me një përshkrim të shkurtër të metodologjisë dhe karakteristikat social-demografike të të anketuarve. Gjetjet grupohen në 9 seksione:

- Besimi në institucione
- Transparenca dhe llogaridhënia
- Korrupsioni në institucionet publike
- Ndikimi politik
- Angazhimi qytetar
- Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike
- Performanca e institucioneve publike
- Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit
- Gjinia dhe përfshirja sociale

2. Metodologjia

2.1 Qasja

Në Sondazhin e Opinionit është përdorur qasja e kampionimit me kuota për të përzgjedhur një numër të barabartë të anketuarish në secilën prej 61 bashkive në vend (n=27). Ndërkohë, u përdor kontrolli i kuotës (quota controls) për përfaqësimin gjinor dhe klasifikimin urban-rural. Me përzgjedhjen e kuotave të barabarta për secilën bashki, është synuar përfshirja e një larmie të madhe profilesh të të anketuarve në lidhje me moshën e tyre, nivelin arsimor, statusin e punësimit, por edhe vulnerabilitetin. Megjithatë, duke qenë se ka vetëm dy kontrolle kuotash, karakteristikat e tjera të kampionit janë të ndryshme.¹

Instrumenti i sondazhit, pyetësi, përfshin të njëjtat pyetje bazë për besimin, angazhimin qytetar dhe TIK që prej 2013. Gjithsesi, përmbajtja e tij shqyrtohet çdo vit nga një panel ekspertësh në fushat e qeverisjes së mirë dhe shkencave sociale për të qenë në linjë me zhvillimet e fundit në nivel kombëtar dhe në debatin publik. P.sh., për herë të parë në këtë sondazh të opinionit publik, të anketuarit pyeten nëse do të emigronin, brenda apo jashtë vendit, nëse do të kishin mundësi. Në vitet e fundit, popullsia në Shqipëri ka lëvizur nga zonat rurale drejt qendrave urbane apo edhe jashtë vendit, duke ndryshuar plotësisht demografinë e vendit. Dhe vitin e kaluar, vendi mori namin e keq për shkak të renditjes në vendin e dytë në botë sipas një sondazhi për dëshirën për të emigruar².

Nga ana tjetër, në sondazhin e këtij viti, pjesa për ofrimin e shërbimeve publike është zgjeruar me dy shërbime të reja publike - shërbimin e regjistrimit të pronave dhe lejet e ndërimit. Po ashtu, për të ecur me hapin e zhvillimeve në e-qeverisjen në Shqipëri, pjesa e TIK tashmë ka dy pyetje të tjera që lidhen me portalin e-Albania dhe platformën e re të bashkëqeverisjes.

Në Shtojcën 1 jepet një listë e plotë e njësive administrative të përfshira në sondazh. Dymbëdhjetë skuadra me intervistues të trajnuar administruan pyetësin në terren nëpërmjet intervistave ballë-për-ballë duke përdorur metodën PAPI (intervistë personale me laps dhe letër). Të dhënat u përpunuan dhe analizuan për të paraqitur statistikatat përshkruese dhe relacionale, duke përdorur STATA 12.0.

.....

- 1 Për karakteristikat socio-demografike të të anketuarve që prej vitit 2013, refero-juni shtojcës.
- 2 Çdo vit, Gallup boton një sondazh për dëshirën e popullsisë në botë për të emigruar. Për më shumë informacion vizitoni: <https://www.gallup.com/>


2.2 Kufizimet

Rezultatet e Sondazhit të Opinionit ofrojnë një panoramë të perceptimeve dhe qëndrimeve publike dhe si kanë ndryshuar ato me kalimin e kohës. Gjithsesi, ato nuk mund të përgjithësohen për të gjithë popullatën. Qëllimi final i sondazhit është t'i jepet "zë" të gjithë qytetarëve, pavarësisht afërsisë së tyre me qeverinë qendrore apo madhësisë së bashkisë ku banojnë ata, dhe të shqyrtohen tendencat vjetore të perceptimit publik, të qëndrimeve dhe përvojave me qeverisjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në të.

3. Demografia e kampionit

Besimi në qeverisje 2018 përfaqëson një kampion prej 52% burra dhe 48% gra, të ndarë në mënyrë të barabartë mes zonave rurale dhe urbane. Në nivel kombëtar, u intervistuan gjithsej 1,647 qytetarë shqiptarë të moshës 18 vjeç e sipër.

Grafiku 1. Përfaqësimi sipas gjinisë



Baza: N=1633

The age distribution, at an equal proportion 39% of the sample, was in the 18-35 age category (16%, 18–25 years; 23%, 25–34 years), and 39% in the 36-55 age category (19%, 36–45 years; 20%, 46–55 years). The proportion of respondents was progressively fewer in the next two age categories. Refer to the following table for a complete distribution by age.


Tabela 1. Grupmoshat

Mosha	Përqindjet
18-25 vjeç	16%
26-35 vjeç	23%
36-45 vjeç	19%
46-55 vjeç	20%
56-65 vjeç	13%
Mbi 65 vjeç	9%
Gjithsej	100%

Baza: N=1629

Për sa i përket nivelit arsimor, 46% kanë përfunduar vetëm shkollën e mesme, ndërkohë që rreth 24% prej tyre ose janë në procesin e marrjes së një diplome universitare/pasuniversitare ose e kanë përfunduar universitetin. Rreth 23% e kampionit ka kryer vetëm arsimin e detyrueshëm.

Grafiku 2. Niveli arsimor



Base: N=1636

Në lidhje me statusin e punësimit të të anketuarve, 46% e tyre ishin të punësuar në momentin e intervistimit (nga ku 28% ishin të punësuar në sektorin publik, ndërsa 69% në sektorin privat), ndjekur nga të papunët që ishin 32%. 7% e të anketuarve ishin studentë, ndërsa 12% pensionistë.


Tabela 2. Statusi i punësimit

Statusi i punësimit	Përqindjet
I/E punësuar	46%
Sektori publik	28%
Sektori privat	69%
Tjetër	3%
Gjithsej	100%
I/E papunë	32%
Student	6%
Pensionist	12%
Tjetër	4%
Gjithsej	100%

Baza: N=1632

Shpërndarja e të ardhurave individuale mujore e të anketuarve jepet në grafikun e mëposhtëm. Rreth 1/3 e kampionit (32%) nuk kishte të ardhura të rregullta mujore në momentin e intervistimit, ndërsa 28% raportonin deri në 24,000 lekë në muaj. Një përqindje tjetër prej 27% fitonte 24,001-50,000 lekë në muaj dhe vetëm 1% e kampionit kishte të ardhura të rregullta mujore mbi 70,000 lekë.


Grafiku 3. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto)



Baza: N=1604

Kur u pyetën nëse e konsideronin veten si me aftësi të kufizuar, vetëm 5% e të anketuarve vetë-raportuan se kanë një aftësi të kufizuar (n=81).

Grafiku 4. Keni ndonjë aftësi të kufizuar?



Baza: N=1623

7% e të anketuarve deklaruan se i përkisnin një pakice kombëtare. Nga këta, 35% u deklaruan si grekë, 26% si romë, dhe 17% si maqedonas. Shih tabelën e mëposhtme për ndarjen sipas pakicave kombëtare.

Tabela 3. A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?

Pakica	Përqindja
PO	7%
Greke	35% (n=44)
Maqedonase	17% (n=17)
Arumune	1% (n=4)
Rome	26% (n=38)
Egjiptiane	9% (n=4)
Boshnjakë	3% (n=1)
Bullgar	1% (n=2)
Refuzim	8% (n=3)
Gjithsej	100% (n=113)
JO	92%
REFUZIM	1%
Gjithsej	100%

Baza: N=1534

4. Rezultatet e sondazhit të opinionit

4.1 Besimi në institucione

Besimi në institucione, veçanërisht besimi tek institucionet publike, vlerësohet si i rëndësishëm për suksesin e një game të gjerë politikash publike, programesh e rregulloresh që varen nga bashkëpunimi me qytetarët. Mungesa e besimit kompromenton vullnetin e qytetarëve dhe biznesit për t'iu përgjigjur politikave publike duke penguar kështu zhvillimin e qëndrueshëm (OECD 2013).

Për këtë qëllim, “Besimi në institucione” përfaqëson një nga modulet kryesore të Sondazhit të Opinioneve. Të anketuarve u kërkohet që të vlerësojnë në një shkallë me katër pikë, nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam fare besim), sesa ata i besojnë institucioneve kryesore publike dhe politike në nivel qendror dhe vendor, si dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në vend³. Kur të anketuarit shprehin nivelin e tyre të besimit në institucione të caktuara, ne supozojmë se mendimi i tyre bazohet në imazhet institucionale që kanë ndërtuar ata, gjë që përkon me kriteret e përgjithshme ose ligjore që përdorin në vlerësimet e tyre. Supozimi bazë këtu është se për të ndërtuar perceptimet e tyre lidhur me institucionet, qytetarët zhvillojnë pritshmëritë e tyre dhe nuk ka nevojë që të dinë me hollësi se si ndërtohen dhe/ose funksionojnë institucione të caktuara.

Besimi në institucione

Institucionet fetare (73%) janë institucionet më të besuara në 2018, ndërsa partitë politike janë më pak të besuara (22%). Institucionet që marrin vlerësime pozitive besimi nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë: sistemi arsimor (64%), forcat e armatosura (63%), policia e shtetit (58%), organizatat e shoqërisë civile (57%), media (56%) dhe shëndetësia (54%). Faktorët demografikë dhe të tjerë që ndikojnë në nivelin e besimit janë arsimi, statusi i punësimit, grupmosha, si dhe madhësia e bashkisë ku banojnë të anketuarit.

Institucionet fetare ishin institucionet më të besuara në Shqipëri⁴ në 2018 – që besoheshin nga 73% e të anketuarve. Më shumë se 7 në 10 të anketuar raportuan se “kanë shumë besim” (23%) ose “kanë besim” (50%) tek institucionet fetare.

• • • • •

- 3 Tre institucione jo-shqiptare, d.m.th., OKB, NATO dhe BE, i janë shtuar listës kryesisht për shkak të nivelit të lartë të angazhimit të këtyre institucioneve në jetën politike, ekonomike dhe sociale të shoqërisë shqiptare.
- 4 Në të gjithë raportin, vlerësimet e ulëta (1-2) dhe ato të larta (3-4) janë përmbledhur në dy kategori kryesore: prirjen të besojnë dhe prirjen të mos besojnë.


Institucionet e sistemit arsimor dhe forcat e armatosura ishin përkatësisht në institucionet e dyta dhe të treta më të besuara, që besoheshin nga 64% dhe 63% e të anketuarve. Gjithsesi, një përqindje më e madhe e të anketuarve deklaruan se “kanë shumë besim” tek forcat e armatosura (12%) krahasuar me sistemin arsimor (7%). Në rend zbritës, policia e shtetit besohet nga 58% e të anketuarve, pasuar nga organizatat e shoqërisë civile me 57% e të anketuarve dhe media me 56% si dhe shëndetësia që besohet nga 54% e të anketuarve.

Të tre degët e qeverisjes besoheshin nga më pak se gjysma e të anketuarve. Megjithatë, ekzekutivi, krahasuar me legjislativin dhe gjyqësorin, vazhdon të gëzojë një nivel më të lartë besimi. 42% e të anketuarve “kanë shumë besim” (8%) ose “kanë besim” (34%) tek qeveria qendrore. Por, të anketuarit besonin më shumë qeverisjen e tyre vendore (47%) sesa atë qendrore (42%). Nga ana tjetër, Parlamenti gëzonte besimin e më pak se 1/3 e të anketuarve (30%), ndërsa dyshja gjykatat dhe prokuroria besoheshin secila nga vetëm 28% e të anketuarve.

Për të gjashtin vit radhazi, partitë politike ishin institucionet më pak të besuara në 2018 – që besoheshin nga vetëm 22% e të anketuarve, nga të cilët 3% kishin shumë besim, ndërsa 19% kishin besim tek partitë politike.

Në ndryshim me institucionet në vend, organizatat ndërkombëtare, si BE, OKB dhe NATO, ishin institucionet më të besuara në 2018, duke gëzuar besimin e rreth 8 nga 10 të anketuar (përkatësisht 80%, 79%, 81% të besimit publik).


Grafiku 5. Besimi në institucione 2018



Baza: N=1647

Në krahasim me një vit më parë, nga 18 institucione të listuara, 7 prej tyre kanë regjistruar një rritje në besimin e përgjithshëm; dy institucione nuk kanë pasur ndryshim, ndërsa 9 prej tyre kanë regjistruar rënie në nivelin e përgjithshëm të besimit në to.

Grafiku 6. Ndryshimi në besimin e përgjithshëm (p.p) 2017-2018



Për 2018 ose për të dytin vit që vlerësohen të ndarë nga njëri-tjetri, gjyqësori dhe prokuroria kanë regjistruar një rritje prej 7 dhe 6 pikë përqindje (p.p.) përkatësisht. Policia e Shtetit, nga ana tjetër, e ka kthyer rënien e vjetshme në rritje prej 5 p.p. këtë vit. Edhe sektori i medias është me rritje me 2 p.p. Sistemi arsimor, shëndetësia dhe partitë politike kanë pasur një rritje të vogël prej 1 p.p. secila. Ndërsa, forcat e armatosura dhe shoqëria civile kanë ruajtur të njëjtin nivel besimi si vitin e kaluar.

E gjithë qeveria qendrore ka pësuar një rënie prej 5 p.p. për vitin 2018, duke prapësuar tendencën në rritje të saj që nga viti 2015. Edhe Parlamenti ka pësuar një rënie prej 4 p.p. edhe pse institucionet fetare regjistruan rritjen më të madhe të nivelit të përgjithshëm të besimit në 2017, për 2018 besimi në to ka rënë me 3 p.p. Edhe partitë politike dhe bashkitë ishin në rënie me të njëjtin nivel (2 p.p.). Po ashtu, edhe besimi në organizatat ndërkombëtare ka pësuar rënie gjatë 2018 – me 6 p.p. rënie për OKB-në, 5 p.p. për BE-në dhe 3 p.p. për NATO-n.

Tabela 4. Besimi në institucione në vite (2013-2018)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qeveria qendrore	30%	37%	34%	44%	47%	42%
Bashkia	N/A	N/A	N/A	49%	49%	47%
Presidenti	35%	25%	29%	36%	33%	30%
Parlamenti	24%	29%	22%	27%	34%	30%
Gjyqësori	19%	18%	17%	23%	N/A	N/A
Prokuroria	N/A	N/A	N/A	N/A	22%	28%
Gjykatat	N/A	N/A	N/A	N/A	21%	28%
Policia	37%	41%	46%	61%	53%	58%
Forcat e Armatosura	51%	44%	46%	55%	63%	63%
Partitë politike	17%	19%	15%	23%	21%	22%
Shëndetësia	30%	32%	27%	50%	53%	54%
Sistemi arsimor	38%	37%	33%	59%	63%	64%
Media	40%	39%	39%	58%	54%	56%
Institucionet fetare	51%	44%	52%	58%	76%	73%
Shoqëria civile	39%	34%	38%	46%	57%	57%
BE	70%	68%	72%	80%	85%	80%
OKB	N/A	N/A	N/A	80%	85%	79%
NATO	74%	71%	74%	79%	84%	81%

Burimi: Sondazhi i Opinioneve 2013-2018

Besimi në institucionet publike konsiderohet si funksion i vlerësimit institucional, konsideratave të qytetarëve për politikat⁵, cilësisë së rezultateve të politikave, raportimit të medias⁶, perceptimeve rreth ndryshimeve sociale dhe kulturore, por edhe të karakteristikave sociale-demografike, si moshë, arsimit, të ardhurat dhe gjinia (Hetherington 1998). Në këtë pjesë të raportit shqyrtohet nëse besimi në institucione të caktuara ndryshon mes segmenteve të ndryshme social-ekonomike të të anketuarve.


Në nivel të përgjithshëm ose duke kombinuar përgjigjet “kam shumë besim” ose “kam besim” nga të anketuarit, gjetjet e sondazhit tregojnë se si klasifikimi sipas gjinisë është edhe ai sipas vendbanimit urban-rural nuk luan ndonjë rol në besimin tek institucionet. Kjo gjetje është vërtetuar edhe në sondazhet e mëparshme të opinionit.⁷

• • • • •


- 5 Nëse njerëzit mendojnë se qeveria po ndjek objektivat me të cilat ata janë dakord, supozohet se ata kanë më shumë besim tek qeveria.
- 6 Si transmetues të informacionit pozitiv dhe negativ që individët marrin rreth qeverisë.
- 7 Shih Sondazhin e Opinioneve për vitet 2015, 2016 dhe 2017; gjenden në adresën: <http://idmalbania.org/trust-in-governance/>

Të anketuarit e moshuar, veçanërisht ata të grupmoshave “56-65 vjeç” dhe “mbi 66 vjeç” ishin më të prirur të raportonin nivele më të larta besimi në krahasim me grupmoshat e reja. Të anketuarit e grupmoshës “mbi 66 vjeç” ishin më të prirur të besonin tek forcat e armatosura (75%), tek institucionet e sistemit arsimor (73%), shëndetësia (68%), policia (67%), media (65%), OSHC (63%), qeverisja vendore (60%), dhe qeveria qendrore (57%).


Grafiku 7. Besimi në institucione (degët e pushtetit) sipas grupmoshave 2018



Të anketuarit me arsim universitar ishin më të prirur të kishin më shumë besim tek institucionet në krahasim me të anketuarit me nivel ulët arsimor. Të anketuarit me arsim universitar ishin më të prirur të kishin besim te sistemi arsimor (71%), te forcat e armatosura (68%) dhe te bashkia (55%).

Grafiku 8. Besimi në institucione (degët e pushtetit) sipas nivelit arsimor 2018

Për sa i përket statusit të punësimit, ata që ishin të punësuar dukeshin se kishin më shumë besim në përgjithësi. Për më tepër, brenda kategorisë së të punësuarve, nivel më i lartë besimi tregohet nga punonjësit e sektorit publik për të gjitha institucionet e listuara, me përjashtim të institucioneve fetare dhe OSHC-ve.

Grafiku 9. Besimi në institucione (degët e pushtetit) sipas statusit të punësimit 2018

Të gjitha rezultatet përmbledhen në tabelën e mëposhtme, ku ngjyrat evidentojnë ndryshimet pozitive dhe negative nga niveli mesatar i besimit në të gjithë segmentet e ndryshëm social-ekonomik.

Tabela 5. Tabelë e dykrahshme “kam shumë besim” ose “kam besim”

	Qeveria	Bashkia	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Ushtria	Partitë Politike	Shëndetësia	Arsimi	Media	Inst. Fetare	OSHC	
Gjithsej (Besimi)	42%	47%	30%	30%	28%	28%	58%	63%	22%	54%	64%	56%	73%	57%	
Gjinia															
Mashkull	41%	46%	30%	29%	26%	26%	57%	66%	22%	54%	64%	55%	73%	56%	
Femër	43%	48%	32%	31%	30%	32%	59%	64%	23%	55%	66%	58%	76%	62%	
Mosha															
18-25	34%	38%	32%	27%	29%	28%	54%	61%	18%	53%	62%	50%	72%	59%	
26-35	41%	47%	32%	27%	29%	29%	56%	66%	22%	55%	62%	50%	67%	54%	
36-45	42%	47%	33%	28%	25%	28%	55%	58%	22%	52%	65%	58%	74%	61%	
46-55	39%	42%	24%	28%	25%	24%	58%	66%	23%	51%	65%	60%	79%	58%	
56-65	49%	54%	35%	38%	32%	34%	67%	71%	24%	58%	69%	65%	83%	65%	
Mbi 66	57%	60%	33%	37%	31%	33%	67%	75%	31%	68%	73%	65%	76%	63%	
Niveli arsimor															
Arsim bazë	38%	43%	27%	30%	29%	32%	57%	64%	25%	57%	65%	59%	77%	66%	
Shkollë e mesme	42%	45%	30%	28%	26%	25%	58%	65%	18%	52%	62%	57%	75%	56%	
Universitet	47%	55%	38%	34%	30%	30%	61%	68%	27%	58%	71%	55%	71%	58%	
Statusi i punësimit															
I punësuar	Gjithsej	46%	50%	33%	32%	27%	26%	59%	68%	24%	57%	66%	57%	74%	56%
	Publik	64%	71%	45%	45%	39%	34%	71%	76%	37%	66%	77%	65%	70%	59%
	Privat	39%	43%	28%	26%	23%	23%	55%	66%	19%	52%	62%	53%	75%	54%
I papunë	31%	36%	27%	24%	28%	30%	56%	57%	18%	50%	60%	55%	74%	61%	
Student	39%	44%	38%	29%	28%	27%	70%	67%	19%	56%	68%	58%	68%	64%	
Pensionist	58%	63%	30%	39%	33%	36%	55%	77%	30%	64%	73%	64%	80%	65%	
Vendbanimi															
Urban	44%	47%	31%	29%	29%	29%	59%	66%	21%	54%	65%	56%	74%	59%	
Rural	40%	46%	30%	30%	27%	29%	58%	64%	23%	55%	65%	57%	74%	59%	

Shënim: Rrumbullakosur në përqindjen më të afërt

Besimi në institucione sipas madhësisë së bashkisë

Analiza tregon se ndarja “rural-urban” nuk është përcaktuese për nivelin e besimit tek institucionet. Megjithatë, nuk ndodh kështu kur shohim gjetjet e sondazhit nga prizmi i madhësisë së bashkive, numri i popullsisë. Kjo perspektivë presupozon se bashkitë me numër më të madh popullsie, me përqendrim të lartë banorësh, ofrojnë mundësi më të mira social-ekonomike, kushte për t’u angazhuar me sistemet e qeverisjes si dhe standarde më të larta vlerësimi të hapjes, transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve. Duke pasur parasysh të gjitha këto, presupozohet se ato ndikojnë në vendimin personal të të anketuarve nëse duhet t’i besojnë dhe sa t’i besojnë institucioneve të caktuara.

Për qëllime të kësaj analize, ky raport përcakton si bashki të mëdha ato që kanë mbi 100,000 banorë, bashki mesatare ato me 50,000-100,000 banorë dhe bashki të vogla ato me më pak se 50,000 banorë. Kështu, raporti i referohet bazës së të dhënave të Regjistrat Civil, të dhënat e të cilit sugjerojnë si më poshtë:

- **Bashkitë e mëdha** (17% e kampionit të sondazhit): Durrës, Elbasan, Fier, Lushnje, Korçë, Lezhe, Shkodër, Kamzë, Tiranë dhe Vlorë.
- **Bashkitë mesatare** (21% e kampionit të sondazhit): Berat, Kuçovë, Dibër, Krujë, Divjakë, Gjirokastrë, Maliq, Pogradec, Kukës, Kurbin, Malësi e Madhe, Kavajë dhe Sarandë.
- **Bashkitë e vogla** (62% e kampionit të sondazhit) – pjesa tjetër e mbetur prej 38 bashkish.

Duke pasur parasysh dominimin e bashkive të vogla në kampionin e sondazhit, është e kuptueshme se kjo pjesë e të anketuarve do të përcaktojnë mesataren e nivelit kombëtar të besimit në secilin institucion. Gjithsesi, për një numër institucioneesh nuk ka dallime të mëdha (më shumë se 5 p.p.) në nivelin e besimit e të anketuarve nga bashkitë e mëdha, mesatare dhe të vogla. Ky është rasti me bashkitë, Presidentin, Parlamentin, gjykatat, partitë politike dhe institucionet arsimore.

Megjithatë, madhësia e bashkisë nuk duket se është përcaktuese për dallimet e konsiderueshme në nivelin e besimit tek institucionet e tjera. Qeveria qendrore gëzon nivel më të lartë besimi mes të anketuarve nga bashkitë e mesme, sesa nga ata që jetojnë në bashkitë e vogla apo të mëdha. I njëjti përfundim vlen edhe për policinë, forcat e armatosura, shëndetësinë, median, dhe institucionet fetare.

Të anketuarit nga bashkitë e mëdha tregojnë nivelin më të ulët të besimit tek policia, media dhe institucionet fetare krahasuar me të anketuarit nga dy grupet e tjera. Nga ana tjetër, të anketuarit e pyetur në këtë sondazh nga bashkitë e vogla kanë më pak besim se ata nga dy grupet e tjera tek këto institucione: forcat e armatosura dhe shëndetësia si dhe tek tre organizatat ndërkombëtare, d.m.th., BE, OKB dhe NATO, të cilat gëzojnë nivelin më të lartë të besimit tek të anketuarit nga bashkitë e mëdha. Në tabelën e mëposhtme jepen të përmbledhura rezultatet e hollësishme.

Tabela 6. Besimi në institucione sipas madhësisë së bashkive

		Qeveria	Bashkia	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Ushtria	Partitë Politike	Shëndetësia	Arsimi	Media	Inst. Fetare	OSHC	BE	OKB	NATO
Gjithsej (Besimi)		42	47	30	30	28	28	58	63	22	54	64	56	73	57	80	79	81
Të anketuar nga bashkitë e mëdha (+100.000 banorë)	Kam besim	42	48	33	32	32	31	40	67	23	56	68	48	70	62	86	87	86
	Nuk kam besim	58	52	67	68	68	69	60	34	77	44	32	52	30	38	14	13	14
Të anketuar nga bashkitë e mesme (50.000-100.000 banorë)	Kam besim	49	46	32	32	30	31	66	74	21	62	67	61	77	54	82	81	85
	Nuk kam besim	51	54	68	68	70	69	34	26	79	39	33	39	23	46	18	19	15
Të anketuar nga bashkitë e vogla (më pak se 50.000 banorë)	Kam besim	40	46	30	29	26	27	55	62	22	52	63	57	75	60	78	79	80
	Nuk kam besim	60	54	70	71	74	73	45	38	78	48	37	43	25	40	22	21	20

Shënim: Rrumbullakosur në përqindjen më të afërt


Reforma në drejtësi

Të dhënat e sondazhit tregojnë se si pritshmëritë pozitive publike për ndikimin e reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit ashtu edhe besimi se kjo reformë po zbatohet siç duhet kanë humbur vazhdimisht terren në tre vitet e fundit. Në 2018, 53% e të anketuarve besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv, ndërsa vetëm 35% thonë se reforma po zbatohet siç duhet, me një rënie prej 8 p.p. nga 2017 dhe 11 p.p. nga 2016.

Përqindja e të anketuarve që besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv ka rënë nga 71% në 2016 në 53% në 2018. Një përqindje më e madhe e të anketuarve (22%) janë të pasigurt në përgjigje krahasuar me 16% në 2017 dhe 11% në 2016.

Pyetje: A besoni se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit?

Grafiku 10. Ndikimi pozitiv i reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit




Baza: N1=1639, N2=1644, N3=1642

Pritshmëritë në rënie për ndikimin pozitiv të mundshëm të reformës në drejtësi duket se lidhen me perceptimet e ndara për sa i përket zbatimit të duhur të saj në praktikë. Përqindja e të anketuarve që besojnë se reforma në drejtësi po zbatohet siç duhet nuk e ka kaluar asnjëherë 50% në këto tre vitet e fundit. Por, për herë të parë në 2018 një numër më i madh të anketuarish besojnë se reforma në drejtësi nuk po zbatohet siç duhet. 35% e të anketuarve raportuan se reforma në drejtësi po zbatohet siç duhet, me një rënie prej 8 p.p.

nga 2017 dhe 11 p.p. nga 2016, ndërsa një tjetër 41% kishin mendim të kundërt. Pothuajse 1 në 4 të anketuar ishin të pasigurt dhe u përgjigjën “Nuk e di”, me një rritje prej 12 p.p. që nga viti 2016.

Pyetje: A besoni se reforma në drejtësi po zbatohet siç duhet?

Grafiku 11 Zbatimi i duhur i reformës në drejtësi



Baza: N₁=1641, N₂=1646, N₃=1645


Analiza social-demografike tregon se klasifikimi sipas gjinisë, vendbanimit urban-rural dhe nivelit arsimor nuk duket se luajnë ndonjë rol në perceptimet e të anketuarve për reformën në drejtësi. Por të anketuarit veçanërisht ata të grupmoshës “56-65 vjeç” dhe “mbi 66 vjeç” prireshin më shumë të raportonin nivele më të larta të besimit në zbatimin e duhur të reformës në drejtësi (45%) kur krahasohen me grupmoshat e reja.

Media

Edhe pse 56% e të anketuarve i besonin medias në 2018, besueshmëria e perceptuar e raportimit nga media ka rënë me 8 p.p. në tre vitet e fundit. Vetëm 42% besojnë se informacioni i dhënë nga media është i saktë dhe i vërtetë dhe më shumë se 1/3 ose 34% kanë mendim të kundërt.

Në 2018, televizioni mbetet mediumi më i përdorur më pjesën më të madhe të të anketuarve (66%), edhe pse ky medium ka rënë në përqindje nga 74% që ishte në vitin 2016. Mediumi tjetër më popullor janë platformat e rrjeteve sociale (22%), të ndjekur nga portalet (7%) dhe gazetat (4%).


Grafiku 12. Cilën media përdorni më shumë?



Baza: N=1638

Edhe pse 56% e të anketuarve deklarojnë se i besojnë medias në 2018, kur pyeten për besueshmërinë e raportimit të medias, vetëm 42% e tyre besojnë se informacioni që jepet nga media ishte i saktë dhe i vërtetë; më shumë se 1/3 ose 34% kanë mendim të kundërt. Të anketuarit me nivel më të ulët arsimor (50%) dhe që i përkisnin grupmoshave të moshuara (50% për “56-65 vjeç” dhe 53% për “mbi 66 vjeç”) ishin më të prirur të raportonin se informacioni i dhënë nga media ishte i saktë .


Krahasuar me dy vite më parë, besueshmëria e raportimit të medias ka rënë me 8 p.p. Për më tepër, përqindja e përgjigjeve “nuk e di” është rritur në 24% në 2018 krahasuar me 15% që ishte në vitin 2016.

Grafiku 13 A është i saktë/i vërtetë informacioni që jepet në media?

Baza: N₁=1639, N₂=1646, N₃=1643

Largimi nga Shqipëria?

Pyetja e mëposhtme u bë për herë të parë në këtë Sondazh të Opinioneve të vitit 2018. Kur pyeten nëse do të largoheshin nga vendbanimi aktual, 55% e të anketuarve u përgjigjën “po”. Nga kjo përqindje, 47% do të largoheshin nga Shqipëria, ndërsa vetëm 8% brenda Shqipërisë. Analiza social-demografike tregon se klasifikimi sipas gjinisë dhe vendbanimit urban-rural nuk duket se luajnë ndonjë rol në perceptimet e të anketuarve. Nga ana tjetër, të anketuarit e papunë ishin më të prirur të deklaronin se do të donit të largoheshin nga Shqipëria krahasuar me të anketuarit në marrëdhënie pune (57% përkundër 46%). Për më tepër, tendenca për t’u larguar kishte korrelacion negativ me moshën, por pozitiv me nivelin arsimor (36% e të anketuarve me arsim bazë do të donin të largoheshin nga Shqipëria përkundër 53% të atyre me diplomë universitare).

Grafiku 14. A do të donit të largoheni nga vendbanimi juaj aktual?

Baza: N=1641

4.2 Transparenca dhe llogaridhënia

Si transparenca ashtu edhe llogaridhënia në administratën publike kanë rëndësi për teorinë dhe praktikën e qeverisjes së mirë dhe konsiderohen si elementë thelbësorë për çdo regjim demokratik. Në këtë aspekt, ndërtimi i institucioneve të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet është evidentuar si një nga synimet kryesorë të Objektivit 16 të Axhendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.⁸

Qeveria e hapur qëndron në themel të konceptit të transparencës. Kjo përfshin, ndër të tjera, qeverinë që është transparente në mënyrën si funksionon, në veprimtarinë dhe shpenzimet e saj, si dhe për operacionet dhe vendimet që merr. Një element kryesor i transparencës është e drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Megjithatë, transparenca përfshin edhe elementë të tjerë, si mundësia e pjesëmarrjes së publikut në takimet e organeve vendimmarrëse.

Transparenca dhe llogaridhënia përforcojnë dhe janë në varësi të njëra-tjetrës. Llogaridhënia bazohet në supozimin se qeveria duhet të mbajë përgjegjësi për vendimet dhe veprimet e saj. Llogaridhënia ka dy dimensione: detyrimi për përgjigje – ose detyrimi i autoriteteve publike për t'i dhënë informacione dhe shpjegime publikut për veprimtarinë e tyre, dhe zbatimi – ose mekanizmi me anë të të cilit informacioni i marrë nga detyrimi për përgjigje të rezultojë efikas në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Llogaridhënia mund të jetë vertikale –përgjigja drejtpërdrejtë ndaj publikut– ose horizontale –që jepet nëpërmjet mekanizmave që veprojnë midis institucioneve publike.⁹

Moduli i dytë i këtij Sondazhi të Opinioni mbulon “transparencën dhe llogaridhënien” dhe u prezantua në tërësinë e tij në vitin 2016. Së pari, të anketuarve u kërkohet të vlerësojnë me një shkallë me 4 pikë nga 1 (plotësisht dakord) në 4 (aspak dakord) transparencën dhe llogaridhënien institucionale të qeverisë në të dy nivelet, qendrore dhe vendore. Më pas, duke u fokusuar tek transparenca, shqyrtohet përvoja e të anketuarve në ushtrimin e të drejtës për informim. Për më tepër, në sondazh bëhen disa pyetje të reja për të matur perceptimin e publikut për ndikimin e nismave të bërjes publike të dosjeve të ish-sigurimit në Shqipëri. Së fundi, duke u fokusuar tek transparenca, të anketuarve u kërkohet të vlerësojnë efektivitetin e institucioneve të ndryshme për zbatimin e llogaridhënies gjatë vitit të kaluar.

• • • • •


- 8 Objektivi 16 për Zhvillimit të Qëndrueshëm: ‘Promovimi i shoqërive të drejta, paqësore dhe gjithëpërfshirëse për të mundësuar drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.’ Për më shumë informacion vizitoni: <http://www.un.org/sustainabledevelopment/sustainable-development-goals/>
- 9 Shpjegimi për këtë koncept bazohet kryesisht në dokumentin “Standardet Ndërkombëtare për Transparencën dhe Llogaridhënien” Qendra për Ligj dhe Demokraci (Briefing Paper “International Standards on Transparency and Accountability”. Centre for Law and Democracy (2014). Marrë nga adresa http://www.law-democracy.org/live/wp-content/uploads/2014/04/Transparency-and-Accountability.final_.Mar14.pdf

Transparenca

Të dhënat e sondazhit tregojnë se për 2018 të anketuarit vazhdojnë ta perceptojnë bashkinë si më transparente dhe që vepron më hapur sesa qeveria qendrore, edhe pse vlerësimet pozitive të transparencës institucionale nuk i kalojnë 40% të të anketuarve. Shumica e të anketuarve mendojnë se si bashkive ashtu edhe qeverisë qendrore në përgjithësi u mungon transparenca. Të anketuarit nga bashkitë e mëdha kanë një mendim më pozitiv për transparencën e bashkive të tyre në krahasim me të anketuarit nga bashkitë e mesme dhe ato të vogla.


Katër nga 10 të anketuar ose 40% janë plotësisht dakord (7%) ose dakord (33%) se bashkia e tyre ishte transparente gjatë 2018, ndërsa shumica ose 58% nuk ishin dakord. Kur u pyetën për transparencën e qeverisë qendrore, kjo dakordësi ra në 1/3 e të anketuarve ose 33%. Pesë për qind e tyre ishin plotësisht dakord se qeveria qendrore ishte transparente gjatë 2018, ndërsa 28% ishin dakord; shumica, ose 64%, nuk ishin dakord se qeveria vepronte në mënyrë të hapur.

Grafiku 15. Transparenca e perceptuar e qeverisë qendrore dhe bashkive 2018




Baza: për qeverinë qendrore, N=1644, për bashkitë, N=1644

Nga krahasimi i tendencave të tre viteve të fundit del se shumica e të anketuarve i perceptojnë bashkitë dhe qeverinë qendrore si institucione jo-transparente. Për më tepër, gjetjet e sondazhit për 2018 tregojnë një trend në rënie të transparencës së perceptuar të institucioneve krahasuar me vitet 2016 dhe 2017. Në këtë aspekt, të anketuarit i perceptojnë si bashkitë ashtu edhe qeverinë qendrore si më pak transparente krahasuar me 2017.

Grafiku 16. Ndryshimet në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2018

Të anketuarit nga bashkitë e mëdha (+100.000 banorë) kanë një mendim më pozitiv për transparencën e bashkisë së tyre në krahasim me të anketuarit nga bashkitë e mesme (50.000 – 100.000 banorë) dhe bashkitë e vogla (më pak se 50.000 banorë). Nuk vihen re dallime të konsiderueshme në lidhje me transparencën e qeverisë qendrore.

Grafiku 17. Transparenca e perceptuar e institucioneve dhe madhësia e bashkive

Ushtrimi i së drejtës për informim


Niveli i ndërgjegjësimit të publikut për Ligjin “Për të drejtën e informimit” ka mbetur i pandryshuar në rreth 60% të të anketuarve. 19% e të anketuarve që janë në dijeni të Ligjit “Për të drejtën e informimit” kanë bërë kërkesë për informacion tek një autoritet publik gjatë 2018. Nga kjo përqindje, shumica ose rreth 65% e kanë marrë informacionin që kanë kërkuar, kurse 35% nuk kanë marrë informacion.

Në Shqipëri e drejta e informimit është e garantuar si nga Kushtetuta ashtu edhe nga Ligji

“Për të drejtën e informimit¹⁰” të miratuar në vitin 2014. Megjithatë, gjetjet e sondazhit tregojnë se numri i të anketuarve që janë të informuar se e drejta për informim u garantohet nga Ligji “Për të drejtën e informimit” nuk ka ndryshuar shumë në tre vitet e fundit dhe se ai është i qëndrueshëm në rreth 60% të të anketuarve. Në 2016 kjo shifër ishte 57% dhe në 2017 dhe 2018 60%.

Pyetje: A jeni në dijeni se në Shqipëri “e drejta e informimit” garantohet me ligj?

Grafiku 18. Sa në dijeni është publiku për Ligjin “Për të drejtën e informimit” në 2018



Baza: N=1636

Ligji “Për të drejtën e informimit” përcakton kërkesat minimale për përmbajtjen e kërkesave për informim. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:¹¹ emrin dhe mbiemrin e kërkuarit; adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; përshkrimin e informacionit që kërkohet; formatin në të cilin preferohet informacioni; çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Nuk aplikohen tarifa për kërkesën për informim.¹² Të anketuarit që janë në dijeni që ligji u garanton të drejtën

.....


10 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Marrë nga adresa: <http://www.idp.al/freedom-of-information/?lang=en>.

11 Neni 11 i Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

12 Neni 13 i Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

e informimit u pyetën nëse e kishin ushtruar këtë të drejtë gjatë vitit 2018 dhe nëse kishin bërë ndonjë kërkesë për informim tek një autoritet publik. Për 2018, 19% e të anketuarve në dijeni të Ligjit “Për të drejtën e informimit” (ose n=186)¹³ raportuan se kanë bërë një kërkesë për informacione tek një autoritet publik. Nga kjo përqindje, shumica ose rreth 65% (n=120) raportuan se e kanë marrë informacionin që kërkonin, ndërsa 35% (n=66) pretenduan për të kundërtën.

Grafiku 19. Kërkesat e bëra për informacion 2016-2018



Baza: N₁=935, N₂=962, N₃=979

Gjetjet e sondazhit tregojnë se gjatë tre viteve të fundit, përqindja e të anketuarve që kanë bërë kërkesë për informim mbetet e kufizuar në rreth 1 në 5 shqiptarë që janë në dijeni të Ligjit “Për të drejtën e informimit”, duke ndryshuar nga 23% në 2016 në 19% në 2018. Për sa i përket informacionit të kërkuar, edhe pse pjesa më e madhe e kërkesave kanë marrë informacione, duket se ka një tendencë në rënie në marrjen e informacionit nga 7% në 2016 në 65% në 2018.

.....

13 N do të thotë numri i vëzhgimeve.

Grafiku 20. Informacioni i kërkuar që është marrë 2016-2018



Baza: N₁=238, N₂=205, N₃=186

Hapja e dosjeve të ish-Sigurimit

Më shumë se gjysma e të anketuarve e konsiderojnë nismën për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit si të dobishme për kryerjen me sukses të punës nga institucionet publike, për të sjellë drejtësinë dhe për të ndihmuar në përmirësimin e përfshirjes sociale. Por në krahasim me vitin 2017, është rritur përqindja e të anketuarve që janë skeptikë për perspektivat e kësaj nisme në 2018


Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent. Për këtë qëllim, me këtë ligj u krijua edhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe bërjen transparente të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit.¹⁴

Për të dytin vit radhazi, kur u pyetën për perspektivën e kësaj nisme, më shumë se gjysma e të anketuarve ose 56% e perceptonin këtë nismë si të dobishme për kryerjen me sukses të punës nga institucionet publike; e njëjta përqindje e perceptonin si të nevojshme për të sjellë drejtësinë dhe 50% për të ndihmuar në përmirësimin e përfshirjes sociale.

.....

14 Ligji Nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të”. Marrë nga adresa <http://autoriteti-dosjeve.gov.al/baza-ligjore/>

Grafiku 21. Nisma për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit 2018



Baza: N=1638

Krahasuar me vitin 2017, një numër më i vogël të anketuarish në 2018 e konsiderojnë hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit si të dobishme për kryerjen me sukses të punës nga institucionet publike, për të sjellë drejtësinë e nevojshme si dhe për përmirësimin e përfshirjes sociale. Edhe përqindja e përgjigjeve “Nuk e di” u rrit gjatë 2018. Për krahasimin e rezultateve referojuni tabelës së mëposhtme..

Tabela 7. Nisma për hapjen e dosjeve të ish Sigurimit të Shtetit 2017-2018


	Po		Jo		Nuk e di	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018
E dobishme për kryerjen me sukses të punës nga institucionet publike	67%	56%	14%	22%	19%	22%
Sjell drejtësinë e nevojshme	65%	56%	16%	23%	19%	21%
Ndihmon në përmirësimin e përfshirjes sociale	60%	50%	16%	23%	24%	27%

Llogaridhënia

Duke qenë se transparenca dhe llogaridhënia janë të ndërlidhura, në të njëjtat linja me rezultatet nga seksioni i transparencës, të anketuarit priren ta konsiderojnë bashkinë e tyre si më të përgjegjshme sesa qeverinë qendrore, edhe pse perceptimet pozitive mbeten të ulëta nën 40% për vitin 2018. Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë se bashkia e tyre dhe qeveria qendrore përgjithësisht nuk janë të përgjegjshme. Po ashtu, të anketuarit nga bashkitë e mëdha e konsiderojnë bashkinë e tyre si të përgjegjshme në përqindje më të larta sesa të anketuarit nga bashkitë e mesme dhe të vogla.

Plot 38% e të anketuarve janë plotësisht dakord (6%) ose dakord (32%) se bashkia e tyre është e përgjegjshme gjatë 2018, ndërsa shumica ose 6 nga 10 të anketuar nuk ishin dakord. Për sa i përket qeverisë qendrore, 34% e tyre ose ishin plotësisht dakord (5%) ose dakord (29%) se qeveria qendrore tregohet e përgjegjshme; 63% ose nuk ishin dakord (41%) ose aspak dakord (22%).


Grafiku 22. Llogaridhënia e perceptuar e qeverisë qendrore dhe bashkive 2018



Baza: Për qeverinë qendrore, N=1644, Për bashkinë, N=1643


Të anketuarit nga bashkitë e mëdha kanë një mendim më pozitiv për llogaridhënien e bashkisë së tyre sesa të anketuarit nga bashkitë e mesme ato të vogla.

Grafiku 23. Llogaridhënia e perceptuar dhe madhësia e bashkisë



Nga krahasimi i tendencave të tre viteve të fundit del në pah se perceptimet pozitive për qeveritë vendore e qendrore kanë pësuar një rënie në 2018. Të anketuarit i konsiderojnë si qeverinë qendrore ashtu edhe bashkinë si më pak të përgjegjshme (që japin më pak llogari) (-4 p.p. dhe 5 p.p.) në krahasim me vitin 2017.

Grafiku 24. Ndryshimet në llogaridhënien e perceptuar 2016-2018



Efektiviteti i institucioneve në zbatimin e llogaridhënies

Për të tretin vit radhazi, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) perceptohet nga 61% e të anketuarve si institucioni që ka rolin më të madh për ta bërë qeverinë të përgjegjshme (për t'i kërkuar llogari), ndjekur nga media (58% e të anketuarve). Megjithatë, në 2018 krahasuar me 2017, të gjitha institucionet konsiderohen sikur kanë një rol më të vogël në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë dhe rënia më e madhe shihet tek partitë e opozitës (rënie prej 11 p.p.) pasuar nga Parlamenti (me rënie prej 9 p.p.).


Analiza e mëposhtme e rezultateve të sondazhit bazohet në dy forma kryesore të llogaridhënies: Llogaridhënia horizontale ose aftësia e institucioneve shtetërore (si legjislativi dhe gjyqësori) për të mbikëqyrur qeverinë duke kërkuar informacione, duke marrë në pyetje zyrtarët dhe ndëshkuar sjelljet e gabuara, llogaridhënia vertikale ose mënyra se si qytetarët, media, dhe shoqëria civile kërkojnë zbatimin e standardeve të performancës së mirë tek zyrtarët publikë.¹⁵

Për sa i përket efektivitetit të institucioneve horizontale në zbatimin e llogaridhënies, 61% e të anketuarve e konsiderojnë Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) si institucioni që i kërkon llogari qeverisë gjatë 2018, pasuar nga Parlamenti të cilin e konsiderojnë 54% e të anketuarve. Megjithatë, më pak se gjysma e të anketuarve mendojnë se Avokati i Popullit (49%) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (44%) i kërkuan llogari qeverisë gjatë vitit 2018. 43% e të anketuarve mendonin se partitë e opozitës (43%) i kërkonin llogari qeverisë, ndërsa shumica ose 54% pohuan të kundërtën.

• • • • •


15 Staphenhurst, R. Llogaridhënia në qeverisje (Accountability in Governance), Dokument i Bankës Botërore 4.

Grafiku 25. Efektiviteti i perceptuar i mekanizmave të llogaridhënies horizontale 2018



Për sa i përket efektivitetit të institucioneve në zbatimin e llogaridhënies vertikale, 58% e të anketuarve mendonin se media i kërkonte llogari qeverisë gjatë 2018. Megjithatë, më pak se gjysma e të anketuarve thanë se shoqëria civile (49%), sindikatat (46%) dhe biznesi (40%) i kërkonin llogari qeverisë gjatë 2018.

Grafiku 26. Efektiviteti i perceptuar i mekanizmave të llogaridhënies vertikale 2018



Në tre vitet e fundit, KLSH vazhdon të konsiderohet si me rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë, me një interval 61-67%, pasuar nga media me një interval 58-62%.

Megjithatë, krahasuar me 2017, asnjë institucion nuk perceptohet të ketë rol në rritje për kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë. Nga ana tjetër, të gjitha institucionet konsiderohen se i kërkojnë më pak llogari qeverisë dhe rënia më e madhe vihet re tek partitë e opozitës (11 p.p.), ndjekur nga Parlamenti (9 p.p.). Shih grafikun dhe tabelën e mëposhtme për shpërndarjen e plotë të rezultateve.

Grafiku 27. Ndryshimet në efektivitetin e perceptuar të mekanizmave të llogaridhënies 2017-2018




Tabela 8. Llogaridhënia 2015-2018

	2016	2017	2018
Parlamenti	51%	63%	54%
Partitë e opozitës	51%	54%	43%
KLSH	63%	67%	61%
Avokati i Popullit	54%	55%	59%
Komisioneri kundër Diskriminimit	46%	45%	44%
Media	62%	65%	58%
Biznesi	43%	44%	40%
Sindikatat	39%	46%	42%
Shoqëria civile	46%	51%	49%

4.3 Korrupsioni në institucionet publike

Transparency International e përkufizon korrupsionin si abuzimi me pushtetin e dhënë për përfitime personale¹⁶. Korrupsioni mund të klasifikohet si i nivelit të lartë ose i nivelit të ulët, në varësi të shumës së parave të humbura në sektorin ku ndodh. Korrupsioni i nivelit të ulët (korrupsioni i vogël) përfshin zyrtarë publikë të nivelit të mesëm-ulët dhe përgjithësisht cenon anëtarët më të varfër të shoqërisë gjatë ndërveprimeve të tyre me administratën për shërbimet publike. Korrupsioni i nivelit të lartë (korrupsioni i madh) përfshin vendimmarrësit politikë dhe zyrtarët e lartë publikë të cilët shfrytëzojnë pozicionet e tyre për të marrë rryshfete, përfituar shuma të mëdha parash apo për të përshtatur rregulloret për përfitimin e interesave të tyre private. (Andvig et al.2001).

Moduli “korrupsioni në institucionet publike” i Sondazhit të Opinioneve u rishikua për të përfshirë disa pyetje të reja që lidhen me klasifikimin e korrupsionit. Që nga 2017, të anketuarve u bëhen pyetje për të vlerësuar përhapjen e korrupsionit të nivelit të ulët e të lartë në një shkallë me katër pikë që fillon nga 1 (aspak i përhapur) në 4 (shumë i përhapur). Më pas, ata pyeten për nivelin e besimit në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit në një shkallë me katër pikë që fillon nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim). Së fundi, të anketuarve u bëhen pyetje të hapura në lidhje me institucionin publik më të korruptuar në Shqipëri për vitin e kaluar.

Pasi janë pyetur për perceptimet e tyre mbi korrupsionin, të intervistuarit u pyetën për përballjet e tyre personale me fenomenin në të dy nivelet e qeverisjes, përfshirë edhe pyetje për të parë se sa prej tyre kanë qenë dëshmitarë të një rasti korruptiv, apo nëse kanë paguar ndonjë rryshfet gjatë vitit të kaluar. Këto pyetje janë prezantuar vazhdimisht në sondazhin e opinionit që nga viti 2015.

Perceptimet për përhapjen e korrupsionit


Më shumë se 8 nga 10 të anketuar e perceptojnë korrupsionin e nivelit të ulët e të lartë si të përhapur në shoqërinë shqiptare për vitin 2018. Krahasuar me vitin 2017, nuk ka ndryshime në nivelet e perceptimit.

Për të dytin vit radhazi, të anketuarit vazhdojnë ta perceptojnë korrupsionin si tejet të përhapur dhe të pranishëm kudo në shoqërinë shqiptare, pavarësisht formës së tij. Shumica dërrmuese e të anketuarve ose 87% e konsiderojnë korrupsionin si të përhapur (53%) ose shumë të përhapur (34%) gjatë vitit 2018. Për sa i përket korrupsionit të nivelit të lartë, në të njëjtat përqindje, 89% e të anketuarve mendojnë se ai është i përhapur (48%) ose shumë i përhapur (41%). Vetëm 8% e të anketuarve mendojnë se korrupsioni nuk është aspak i përhapur (shumë i rrallë) (1%) ose jo i përhapur (deri diku i rrallë) (7%).

• • • • •

16 Për më shumë informacion shih <https://www.transparency.org/what-is-corruption>

Grafiku 28. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit 2018



Baza: Për korrupsionin e nivelit të lartë, N=1644, Për korrupsionin e nivelit të ulët, N=1644

Tabela 9. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit 2017-2018

		2017	2018
Korrupsioni i nivelit të ulët	I përhapur	54%	53%
	Shumë i përhapur	33%	34%
Korrupsioni i nivelit të lartë	I përhapur	48%	48%
	Shumë i përhapur	40%	41%

1,329 të anketuar iu përgjigjën pyetjeve të hapura për institucionin më të korruptuar për vitin 2018. 34% e tyre konsideronin sistemin gjyqësor si më të korruptuarin, ndjekur nga qeveria (14%) dhe Parlamenti (12%).


Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit

Të anketuarit në përgjithësi nuk kanë shumë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit duke konfirmuar kështu vlerësimet për besimin e ulët në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, të anketuarit kanë më pak besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të lartë krahasuar me rastet e korrupsionit të nivelit të ulët – me një diferencë prej 9 pikë përqindjeje. Ky mosbesim për ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të lartë deklarohet më shumë nga të anketuarit nga bashkitë e mëdha.

Vetëm 36% e të anketuarve kishin shumë besim (6%) ose besim (30%) në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët në 2018. Shumica e të anketuarve ose 62% ose nuk kishin besim (39%) ose aspak besim (23%) në këtë drejtim. Përqindjet e përgjigjeve

në 2018 kanë mbetur të pandryshuara që nga viti 2017. Për ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, niveli i besimit të raportuar bie në 27% e të anketuarve. 6% e të intervistuarve kishin shumë besim dhe 21% kishin besim (20%), ndërkohë që 71% nuk kishin besim (40%) ose aspak besim (31) në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë.

Grafiku 29. Perceptimi për ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit 2018



Baza: Për korupsionin e nivelit të lartë, N=1644, Për korupsionin e nivelit të ulët, N=1644

Nuk u vunë re ndryshime të konsiderueshme në opinionet e të anketuarve sipas gjinisë dhe vendbanimit. Megjithatë, të anketuarit veçanërisht ata të grupmoshës “56-65 vjeç” dhe “mbi 66 vjeç” prireshin më shumë të kishin besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët dhe të madh, krahasuar me grupmoshat e reja (45% dhe 44% për korupsionin e nivelit të ulët dhe 33% dhe 42% për korupsionin e nivelit të lartë).


Të anketuarit nga bashkitë e mëdha duket se janë më mosbesues se të anketuarit e tjerë kur pyeten për ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Kështu, 78% e tyre nuk kanë besim përkundër 71% e të anketuarve nga bashkitë e mesme dhe 72% e të intervistuarve nga bashkitë e vogla.

Përballja personale me rastet e korupsionit

Të dhënat e sondazhit tregojnë një mospërputhje të dukshme mes perceptimeve për përhapjen e korupsionit dhe përvojave të raportuara personale të përballjes me rastet e korupsionit. Për vitin 2018, 21% e të anketuarve kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast korupsioni në bashkinë e tyre, ndërsa 14% kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast korupsioni në qeverinë qendrore. Në krahasim me vitin 2017, nuk ka ndryshime të konsiderueshme për përballjen me rastet e korupsionit.

Për sa i përket përballjes personale me rastet e korrupsionit, 21% e të anketuarve (ose n=335) kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast korrupsioni në bashkinë e tyre, ndërsa 14% (ose n=231) kanë qenë dëshmitarë në të paktën një rast korrupsioni në qeverinë qendrore. Nuk ka dallime për përballjen personale me rastet e korrupsionit mes grupeve të ndryshme social-demografike.


Grafiku 30. Përballja personale me rastet korrupsionit 2018



Baza: Për qeverinë qendrore N =1631, Për qeverinë vendore N =1631

Në lidhje me tendencat në përballjen personale me korrupsionin gjatë këtyre viteve, të dhënat e sondazhit tregojnë se niveli më i lartë i përballjes së raportuar u evidentua në vitin 2015 (41% në nivel vendor dhe 34% në nivel qendror), pasuar nga niveli më i ulët në 2016 (15% në nivel vendor dhe 10% në nivel qendror). Në krahasim me vitin 2017, nuk ka ndryshime të konsiderueshme për përballjen me rastet e korrupsionit.

Grafiku 31. Përballja personale me korrupsionin 2015-2018




Përhapja e ryshfetit

Nga ata që kanë marrë shërbime gjatë vitit 2018, 30% kanë paguar ryshfet në nivel vendor, ndërsa 24% në nivel qendror. Krahasuar me 2017, ka një rënie të rasteve të raportuara të ryshfetit, veçanërisht në nivel qendror, në 24% në 2018 nga 33% në 2017.


Në grupin e mëposhtëm të pyetjeve, të anketuarit pyeten nëse në 2018 kanë pasur ndonjë kontakt me institucionet në nivel vendor dhe qendror për të marrë ndonjë shërbim. Për ata që kanë marrë shërbime të tilla, u pyetën nëse kanë paguar ryshfet. Më shumë se gjysma e të anketuarve ose 56% (n=932) thanë se kanë marrë shërbime nga institucionet publike në nivel vendor në vitin 2018. Mes tyre që kanë marrë këto shërbime, 30% (n=281) raportojnë të kenë paguar ryshfet.

Grafiku 32. Shërbimet e marra në nivel vendor



Baza: N=1631


Grafiku 33. Ryshfeti i paguar në nivel vendor



Baza: N=924


Në nivel qendror, në vitin 2018 morën shërbime nga institucionet publike 40% e të anketuarve (n=660). Mes tyre që morën shërbime, 24% (n=157) raportuan të kenë paguar ryshfet.

Grafiku 34. Shërbimet e marra nga institucionet publike në nivel qendror



Baza: N=1629

Grafiku 35. Ryshfeti i paguar në nivel qendror 2018



Baza: N=648

Kur u pyetën për arsyet që paguan ryshfet, 42% e të intervistuarve (n=141) deklaruan se paguan ryshfet, sepse iu është kërkuar një gjë e tillë. Një tjetër përqindje 34% (n=117) deklarojnë se kanë paguar ryshfet në mënyrë që të marrin shërbime më të mira herës tjetër, ndërsa 24% e të anketuarve (n=81) thonë se kanë paguar ryshfet në shenjë mirënjohjeje për shërbimet e marra.


Tabela 10. Arsyet për pagesën e ryshfeteve 2018

	Përqindja	Shpeshtësia
Ma kërkuan ryshfetin	42%	141
E dhashë vetë, si mirënjohje për shërbimin e marrë	24%	81
E dhashë vetë, që të marr një shërbim më të mirë herës tjetër	34%	117
Gjithsej	100%	339

Më pas, të anketuarit që pranuan se kanë paguar ryshfet u pyetën nëse e kishin raportuar këtë fenomen tek institucionet përkatëse zyrtare. Vetëm 15 të anketuar nga 344 që iu përgjigjën kësaj pyetjeje pretenduan se e kanë raportuar këtë praktikë, ndërsa shumica ose 329 të anketuar deklaruan se nuk e kishin bërë këtë gjë.

Kur u pyetën për arsyet e mosraportimit, 47% e të anketuarve (n=152) thanë se “Është e kotë të raportosh, askush nuk i kushton rëndësi”; 23% (n=74) thanë se “Të paguash ryshfet është diçka e zakonshme”, pasuar nga 12% të tjerë të anketuar (n=39) që nuk e raportuan se “Kisha frikë nga pasojat e raportimit”. 5% ose 17 të anketuar thanë se “Nuk dija se ku/kujt duhet t’i drejtohesha”.

Për sa i përket përhapjes së ryshfetit në vite, të dhënat e sondazhit tregojnë se krahasuar me 2017, ka një rënie të rasteve të raportuara të ryshfetit, veçanërisht në nivel qendror, nga 33% në 2017 në 24% në 2018. Në nivel vendor, rënia është e papërfillshme (2 p.p.).

Grafiku 36. Përhapja e ryshfetit 2016-2018

4.4 Ndikimi politik

Ndikimi politik, ose suksesi në nxitjen apo ndryshimin e vendimeve politike në përfitim të interesave të grupit, është një dukuri me shumë aspekte që lidhet me përcaktimin e axhendës dhe procesin e vendimmarrjes.


Në modulën “Ndikimi i interesave politike” të Sondazhit të Opinioneve, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë nga 1 (politika nuk ndikon aspak) deri në 5 (politika ndikon jashtëzakonisht shumë) sa ndikojnë interesat politike në axhendën e një liste prej 9 institucioneve.

Interesat politike në axhendën e institucioneve

Institucionet fetare konsiderohen si më të pavarurat nga ndikimi politik gjatë vitit 2018, ndërkohë që prokuroria dhe gjykatat si më pak të pavarurat. Të anketuarit nga bashkitë e vogla e perceptojnë si më të fortë ndikimin politik krahasuar me të anketuarit në disa institucione, si shëndetësia dhe institucionet arsimore.

Institucionet fetare konsiderohen si më të pavarurat nga ndikimi politik gjatë vitit 2018. 67% e të anketuarve mendojnë se interesat politike nuk ndikojnë aspak (40%) ose ndikojnë pak (27%) në axhendën e institucioneve fetare, që ndiqen nga OSHC-të që perceptohen si të pavarura nga më pak se gjysma e të anketuarve ose rreth 45%.

Në anën tjetër të spektrit, institucioni i prokurorisë dhe gjykatat perceptohen si më pak të pavarurat nga ndikimi politik. Vetëm 13% e të anketuarve mendojnë se interesat politike nuk ndikojnë aspak (4%) ose ndikojnë pak (9%) në axhendën e prokurorisë. Për sa i përket gjykatave, 14% e të anketuarve mendojnë se interesat politike nuk ndikojnë aspak (4%) ose ndikojnë pak (10%) në axhendën e gjykatave.

Grafiku 37. Perceptimi i ndikimit të interesave politike në axhendën e institucioneve 2018

Nuk u vunë re dallime të konsiderueshme në perceptimet e të anketuarve pavarësisht madhësisë së bashkive të tyre për sa i përket ndikimit politik tek institucionet si prokuroria, gjykata, policia, forcat e armatosura, dhe media. Megjithatë, për pjesën tjetër të institucioneve vihen re disa mospërputhje në qëndrimin e të anketuarve në varësi të vendbanimit të tyre në bashkitë të mëdha, të mesme apo të vogla. Ndikimi politik në sistemin arsimor dhe në institucionet e kujdesit shëndetësor është më i dukshëm në perceptimet e të anketuarve nga bashkitë e vogla (me 37% dhe 38% respektivisht). Ndonëse në një nivel më të ulët, e njëjta tendencë vihet re tek të anketuarit nga bashkitë e mëdha, ndërsa të anketuarit nga bashkitë e mesme tregojnë përqindje më të ulët për një opinion të tillë. Të anketuarit nga bashkitë e vogla tregojnë përqindje më të lartë opinionesh, që shohin ndikim politik tek institucionet fetare. Nga ana tjetër, afro 32% e të anketuarve nga bashkitë e mesme e shohin ndikimin politik të pranishëm tek OSHC-të. Vetëm 25% e të anketuarve nga bashkitë e vogla dhe 18% nga ato të mëdha kanë të njëjtin mendim.

Krahasuar me vitin 2017, të vetmet institucione që kanë pasur një rritje të lehtë në pavarësinë e perceptuar nga ndikimi politik janë gjykatat (4 p.p.) dhe Prokuroria (1 p.p.). Nga ana tjetër, të gjitha institucionet e tjera kanë pasur rënie: institucionet fetare (-9 p.p.), forcat e armatosura (-7 p.p.), sistemi arsimor (-4 p.p.) dhe sistemi shëndetësor (-1 p.p.).

Tabela 11. Perceptimi se “nuk ka aspak ndikim” ose “ka pak ndikim” i interesave politike 2016-2018

	2016	2017	2018
Prokuroria	N/A	12%	13%
Gjykatat	N/A	10%	14%
Policia	20%	24%	22%
Forcat e armatosura	33%	42%	35%
Sistemi shëndetësor	23%	32%	31%
Sistemi arsimor	26%	36%	32%
Media	26%	31%	31%
Institucionet fetare	75%	76%	67%
OSHC	48%	45%	45%

4.5 Angazhimi qytetar

Në këto vitet e fundit, studimet e kryera në Shqipëri kanë nxjerrë në pah një nivel të ulët të angazhimit qytetar në procesin e vendimmarrjes. Një shpjegim i cituar shpesh është trashëgimia komuniste e qeverisjes së centralizuar, ku puna ishte e detyruar dhe qeveria organizohej në nivel qendror me pak mundësi për angazhim nga qytetarët. Si rezultat i epokës komuniste dhe tranzicionit të ngadaltë drejt shtetit ligjor ka mungesë të vazhdueshme të besimit tek autoritetet vendore e qendrore dhe pakënaqësi me rritjen e pabarazive (Dauti, 2017, Partnerët Shqipëri, 2013, IDM, 2010).¹⁷ Kështu, në Sondazhin e Opinioneve të anketuarit u pyetën për pjesëmarrjen e tyre në procesin e vendimmarrjes në institucionet publike; përfaqësimin e nevojave të qytetarëve në qeverisjen vendore; pjesëmarrjen e tyre në demonstrata apo tubime; dëshirën e të anketuarve për t’u përfshirë në punë vullnetare. Për angazhimin me institucionet publike, bëjmë dallimin e këtij angazhimi në nivel qendror e vendor.

•••••


17 Shih për shembull, Dauti, M. (2017). Ndikimi i decentralizimit në pjesëmarrjen e organizimeve formale në Shqipëri: Mësime për ndërhyrjet me bazë komuniteti. Puna sociale ndërkombëtare, 60(6),1523-1536; Partnerët Shqipëri. (2013). Pjesëmarrja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje. Tiranë: Partnerët Shqipëri; dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). (2010). Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë: Në kërkim të qytetarëve dhe ndikimit. Tiranë - IDM.

Pjesëmarrja në vendimmarrjen e institucioneve publike

Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e shqiptarëve nuk ndjehen se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike. Megjithatë, krahasuar me vitet e kaluara, të anketuarit raportojnë se kanë më shumë mundësi për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel qendror e vendor.

Në këto vitet e fundit, të anketuarit kanë raportuar se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike. Për herë të parë, sondazhi i këtij viti përfshiu edhe pyetjen nëse të anketuarit do të ishin të interesuar për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike. Me fjalë të tjera, a do të ishin të interesuar njerëzit për t'u bërë qytetarë aktivë në qeverisjen e vendit? 57% e të anketuarve konfirmuan se do të donin të merrnin pjesë, ndërsa 43% thanë se nuk ishin të interesuar.

Grafiku 38. Interesi për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike 2018




Baza: N = 1635

Nëse analizojmë demografinë, janë veçanërisht studentët (71%) që janë të interesuar për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike. Për më tepër, duket se ka një tendencë për sa i përket moshës së të anketuarve dhe interesit të tyre për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes. Të anketuarit në moshë të re kanë më shumë gjasa të jenë të interesuar për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes krahasuar me të anketuarit në moshë më të madhe. Në grupmoshat 18-25 vjeç dhe 26-35 vjeç, 66% dhe 62% përkatësisht, u raportua se do të donin të merrnin pjesë, ndërsa grupmosha më e vjetër (mbi 65 vjeç), vetëm 40% e të anketuarve ishin të interesuar për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike.

Gjithsesi, edhe pse 57% e shqiptarëve janë të interesuar për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike, raportohen përqindje më të ulëta kur pyeten nëse kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë. Në 2018, shumica e të anketuarve (69%) nuk mendojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel qendror. Vetëm 31% e pjesëmarrësve të këtij sondazhi mendojnë se kanë mundësi të mjaftueshme në nivel qendror. Në nivel vendor, tendenca është më pozitive. Këtu, 40% e të anketuarve besojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, përkundër 60% të të anketuarve që mendojnë të kundërtën.


Grafiku 39. Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes 2018



Baza: $N = 1630$, $N = 1638$

Krahasuar me përgjigjet e viteve të kaluara, numri i përgjigjeve pozitive duket se është në rritje. Në 2016, vetëm 21% mendonin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel qendror, krahasuar me 33 në nivel vendor. Në 2017, këto shifra ishin 28% dhe 36% përkatësisht.

Grafiku 40. Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes 2016-2018




Të ftuar për të marrë pjesë në proceset e konsultimit

Të dhënat e sondazhit tregojnë se gjatë viteve të fundit, përqindja e shqiptarëve që kanë marrë ftesë për të marrë pjesë në konsultimet në nivel vendor e qendror është në rritje.

Në 2018, 16% e të anketuarve ishin ftuar për të marrë pjesë në procesin e konsultimit të organizuara nga institucionet publike në nivel qendror. Në nivel vendor, kjo përqindje ishte pak më e lartë – 25% të të anketuarve që thanë se ishin ftuar për të marrë pjesë në procesin e konsultimit nga institucionet publike.


Grafiku 41. Ftesa për të marrë pjesë në proceset e konsultimit 2018



Baza: N = 1630, N = 1629

Të anketuarit që punonin në sektorin publik (28%) dhe që kishin nivel të lartë arsimit (22%) ishin më të prirur për t'u ftuar për konsultime në nivel qendror. Burrat (20%) kishin më shumë gjasa të ftoheshin në krahasim me gratë (12%). Për konsultimet në nivel vendor, vihet re një tendencë e njëjtë. Të anketuarit meshkuj (30%), të punësuarit në sektorin publik (38%) ose ata me arsim të lartë, d.m.th., ata që kanë të paktën diplomën e ciklit të parë (Bachelor) (34%) kishin më shumë mundësi të merrnin pjesë për të marrë pjesë në konsultimet publike. Për konsultimet në nivel qendror, përqindja e të anketuarve që u ftuan u rrit nga 7% në 2016, në 12% në 2017 dhe 16% në 2018. Për konsultime në nivel vendor, përqindja e të anketuarve të ftuar për të marrë pjesë ishte e njëjtë në 2016 (19%), dhe 2017 (18%), por u rrit shpejt në 25% në 2018.

Grafiku 42. Ftesa për të marrë pjesë në proceset e konsultimit 2016-2018




Pjesëmarrja në takimet e konsultimit

Të dhënat e sondazhit tregojnë se më pak se 10% e shqiptarëve morën pjesë në një konsultim të nivelit qendror. Pothuajse një në pesë të anketuar ka marrë pjesë në një takim konsultimi në nivel vendor. Shumë shpesh, këto ishin takime të organizuara nga bashkia. Të anketuarit që ishin ftuar në një takim konsultimi, por nuk kishin marrë pjesë shpesh, cituan se ata “nuk besojnë në procese të tilla”.

Pavarësisht se 16% e të anketuarve ishin ftuar për të marrë pjesë në një procesi konsultimi nga institucionet publike në nivel qendror, vetëm 8% e të anketuarve thanë se kishin marrë pjesë në një proces të tillë në 2018. Në nivel vendor, 19% e të anketuarve kishin marrë pjesë në një takim konsultimi publik.

Grafiku 43. Pjesëmarrje në takim konsultimi 2018



Baza: $N = 1474$, $N = 1486$

Të anketuarit meshkuj (10%), të punësuarit në sektorin publik (17%) ose ata me arsim të lartë, d.m.th., ata që kanë të paktën diplomën e ciklit të parë (Bachelor) apo më shumë (34%) kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin marrë pjesë në një takim konsultimi publik në nivel qendror. I njëjti përfundim vlen edhe për takimet e konsultimit në nivel vendor. Këtu, të anketuarit meshkuj (25%), të punësuarit në sektorin publik (37%) ose ata me arsim të lartë (29%) kishin më shumë mundësi të merrnin pjesë për të marrë pjesë në konsultimet publike kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin marrë pjesë në një takim konsultimi.

Shumica e të anketuarve që kanë marrë pjesë në takime konsultuese raportuan se takimet ishin organizuar nga bashkia (58%) ose qeveria qendrore (24%). 15% e të anketuarve raportuan kishin marrë pjesë në takime konsultimi publik të organizuara nga këshilli bashkiak. Një përqindje më e vogël raportuan se kanë marrë pjesë në takime konsultimi publik të organizuar nga Parlamenti (6%) ose në një konsultim përmes internetit (4%).

Tabela 12. Llojet e takimeve konsultuese ku kanë marrë pjesë

Takim i hapur organizuar nga bashkia	58% (n = 220)
Seanca këshillimi me bashkësinë organizuar nga këshilli bashkiak	15% (n = 57)
Konsultime publike organizuar nga institucionet qendrore	24% (n = 90)
Konsultime publike organizuar nga Kuvendi	6% (n = 23)
Konsultim përmes internetit	4% (n = 16)
Tjetër (specifiko): *	<1% (n = 1)

*Tjetër: Dëgjesa publike me organizatat e shoqërisë civile / OJQ.

Shënim: Lejohen disa përgjigje; përqindjet mund të mos plotësojnë totalin 100%

Kur u pyetën për arsyet e mospjesëmarrjes në dëgjesat publike të konsultimit, argumenti kryesor ishte se të anketuarit nuk besojnë tek këto procese konsultimi (39%). Rreth 1 në pesë të anketuar u përgjigjën se mendonin që duhet të shkonin të tjerët, gjë që është mjaft interesante po të kemi parasysh se shumica e të anketuarve mendojnë se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike. 11% e të anketuarve thanë se nuk kishin informacion të mjaftueshëm për temën që të merrnin pjesë në konsultime të organizuara nga institucionet publike. Rreth 1 në 10 të intervistuar nuk morën pjesë për arsye logjistike, si pamundësia për të shkuar tek vendi ku organizohej takimi (9%) ose mungesa e internetit (1%).

Tabela 13. Arsyet e mospjesëmarrjes në takimet e konsultimit

Mendoj që duhet të shkojnë të tjerët	19% (n = 198)
Nuk besoj tek këto procese konsultuese	39% (n = 398)
Nuk kam pasur informacion mbi temën që diskutohej	11% (n = 115)
Nuk kisha mundësi të shkoja tek vendi i takimit	9% (n = 96)
Nuk kam akses në internet	2% (n = 15)
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	13% (n = 133)
Tjetër (specifikojë):	7% (n = 68)

**Tjetër: “Nuk më ftuan”, ‘Nuk kam kohë’, ‘Nuk merrem me punë të tilla’, ‘Nuk kam moshë për to’, ‘Ftesa ishte nga një parti (politike) që nuk e mbështes’, ose ‘Edhe sikur të marr pjesë, nuk ta dëgjon kush fjalën’.*


Shënim: Për shkak të rumbullakosjes, përqindjet mund të mos plotësojnë totalin 100%.

Mosbesimi në takimet konsultuese si proces për angazhimin e qytetarëve nuk ndryshon për nga gjinia, arsimit, sektori i punësimit apo vendbanimi rural/urban. Megjithatë, duket se të anketuarit në moshën 45 vjeç (mesatarja = 45%) janë skeptikë për takimet e konsultimit krahasuar me të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (mesatarja = 21%).

Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve

Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e të anketuarve mendojnë se buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve.

Si pjesë e sondazhit të opinionit, të anketuarit u pyetën nëse mendojnë se buxheti i bashkisë ku jetojnë reflekton prioritetet e qytetarëve. Shumica e tyre (62%) thonë se buxheti i bashkisë nuk reflekton prioritetet e qytetarëve. Plot 25% e të intervistuarve thanë se në përgjithësi buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve dhe 6% thanë se buxheti reflekton plotësisht nevojat e qytetarëve. Një tjetër përqindje, 7%, u përgjigjën “Nuk e di/nuk kam ndonjë ide”.

Grafiku 44. Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve

Baza: N = 1638

Të anketuarit që punojnë në sektorin publik (50%), ata me diplomë universitare (36%) apo të intervistuarit në moshë të madhe raportojnë se shpesh buxheti i bashkisë së tyre reflekton prioritetet e qytetarëve të tij. Të anketuarit në grupmoshat 56-65 vjeç dhe ata mbi moshën 65 vjeç raportojnë më shpesh (37% dhe 36%) se ata janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin “Buxheti i bashkisë ku unë banoj reflekton prioritetet e qytetarëve” në krahasim me të anketuarit në moshë të re. Nuk u vunë re dallime për nga gjinia, vendbanimi apo statusi i punësimit.

Përfaqësimi dhe angazhimi qytetar

Shumica e të anketuarve janë pesimistë se qeveria mund të dëgjojë shoqërinë civile, të mbrojë interesat dhe mundësitë e qytetarëve për të ndikuar në vendimmarrjen vendore.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për sa i përket disa pohimeve për përfaqësimin dhe angazhimin qytetar. Shumica e të anketuarve (60%) mendojnë se anëtarët e këshillit bashkiak nuk punojnë në interesin e qytetarëve të cilët përfaqësojnë. Për pohimin “Këshilltarët e bashkisë ku unë banoj përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesat e qytetarëve përballë kryetarit të bashkisë dhe administratës bashkiake”, 28% janë dakord dhe 8% janë plotësisht dakord.


Kur u pyetën nëse angazhimi qytetar kontribuon në procesin e vendimmarrjes, në 2018, shumica e të anketuarve janë pesimistë. 67% e të intervistuarve janë dakord ose plotësisht

dakord me pohimin “Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet e këshillave bashkiake”. 60% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord me pohimin “Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë”, gjë që do të thotë se ata nuk mendojnë se sugjerimet e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit merren në konsideratë. Është interesante të theksohet se ky imazh sa vjen e bëhet më negativ me kalimin e kohës. Në 2016, 57% mendonin se dëgjesat publike ishin takime formale, krahasuar me 67% në 2017. E njëjta tendencë vihet re për sa i përket ndikimit të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Në 2016, 54% mendonin se sugjerimet e tyre merreshin parasysh krahasuar me 40% në 2017.

Pohimi: ‘Një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq.’

71% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Kjo përqindje është relativisht e lartë edhe në vitet e kaluara në të cilat 78% (2017) dhe 72% (2016) raportuan se një qytetar i zakonshëm ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq.

Grafiku 45. Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin e qytetarëve 2018



Baza: N = 1639, N = 1635, N = 1639, N = 1640


Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim ose nënshkrimin e një peticioni

Pothuajse 1/4 e të anketuarve kanë marrë pjesë në një tubim/demonstratë ose kanë nënshkruar një peticion gjatë 2018. Shumica e këtyre të anketuarve e kanë bërë këtë për shkak të interesit të përbashkët i komunitetit të cilit i përket i anketuari.

Në Shqipëri janë bërë një sërë protestash gjatë vitit 2018. Në mars, protestuesit shkatërruan sportelet e saponduarta në autostradën që lidh Shqipërinë me Kosovën. Gjatë sezonit të verës, u organizuan disa protesta për të kundërshtuar planet për rindërtimin e teatrit të vjetër nëpërmjet një partneriteti publik-privat, i cili do të zërë edhe tokë publike. Në dhjetor, vendi ubefasua nga protestat e studentëve që zgjatën disa javë ku kërkoheshin reforma në sistemin arsimor.

Nga të anketuarit, 23% kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kishin nënshkruar një peticion në vitin 2018. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit meshkuj (28%), studentët (30%) dhe të anketuarit nën moshën 35 vjeç (28%) thanë se kanë marrë pjesë në një tubim/demonstratë gjatë vitit 2018 ose që kanë nënshkruar një peticion. Krahasuar me vitet e kaluara, përqindja e shqiptarëve që marrin pjesë në demonstrata/tubime apo që nënshkruajnë peticione është e ngjashme. Në vitin 2016, 22% e të anketuarve thanë se kanë marrë pjesë në një tubim/demonstratë ose që kanë nënshkruar një peticion krahasuar me 20% në 2017.

Grafiku 46. Pjesëmarrja në demonstratë/tubim apo nënshkrim peticioni 2018



Baza: N = 1636

Të anketuarit u pyetën edhe për arsyet ose qëllimin për pjesëmarrjen në një tubim apo demonstratë ose për nënshkrimin e një peticioni. Arsyet kryesore për pjesëmarrjen në një tubim apo demonstratë ose për nënshkrimin e një peticioni ishte ‘interesi i përbashkët i komunitetit ku jetoj’ (45%), ndjekur nga ‘interesi personal’ (21%), militantizmi (për mbështetje politike) (12%) dhe ‘presioni i shokëve/të njohurve’ (7%). 15% e të anketuarve

u përgjigjën se ishte kombinim i më shumë se një arsyeje që i bindi ata të merrnin pjesë në një demonstratë/tubim apo të nënshkruanin një peticion.

Tabela 14. Arsyet e pjesëmarrjes në demonstratë/tubim apo për nënshkrimin e një peticioni 2018

Interesi personal	21% (n = 81)
Interesi i përbashkët i komunitetit ku jetoj	45% (n = 172)
Militantizmi (për mbështetje politike)	12% (n = 46)
Presioni i shokëve/të njohurve	7% (n = 25)
Kombinim i më shumë se një arsyeje	15% (n = 51)
Tjetër	<1% (n = 1)


Shënim: Për shkak të rrumbullakosjes përqindjet mund të mos plotësojnë gjithmonë totalin 100%

Dëshira për t'u angazhuar në punë vullnetare për të mirën e komunitetit

Të dhënat e sondazhit tregojnë se në tre vitet e fundit, shumica e shqiptarëve janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare për të mirën e komunitetit. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit në moshë të re, ata me arsim të lartë apo të intervistuarit që punojnë në sektorin publik kanë dëshirë të angazhohen në punë vullnetare.

Pyetja e fundit në lidhje me angazhimin qytetar ishte për dëshirën e të anketuarve për të marrë pjesë në punë vullnetare, ku 67% e tyre thanë se kishin dëshirë të merrnin pjesë në punë vullnetare.

Grafiku 47. Dëshira për t'u angazhuar në punë vullnetare 2018



Baza: N = 1627

Kur analizojmë këto gjetje sipas elementëve social-demografik, shohim se të intervistuarit që punojnë në sektorin publik (80%), ata nën moshën 25 vjeç (77%) ose të anketuarit me arsim të lartë (80%) janë më të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare sesa të tjerët. Gjatë viteve, përqindja e të anketuarve që janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare për të mirën e komunitetit ka pësuar rënie. Në 2016, 77% e të anketuarve janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare. Në 2017, 75% thanë se janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare dhe në 2018 vetëm 67% u shprehën të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare.

4.6 Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në shndërrimin nga një vend me ekonomi të centralizuar në vend ekonomi me orientim drejt tregu.¹⁸ Ky ndryshim rrënjësor i organizimit të shoqërisë ka transformuar marrëdhëniet mes politikëbërësve, ofruesve të shërbimeve dhe qytetarëve. Qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash që lidhen me shërbimet, reforma që kanë ndikuar në marrëdhëniet institucionale, kanë ndryshuar stimujt për ofruesit e shërbimeve në nivel institucioni dhe individit si dhe kanë ndryshuar mënyrat me të cilat marrin pjesë dhe gëzojnë shërbimet qytetarët (Banka Botërore, 2012)¹⁹. Në një mjedis të tillë, opinioni i vazhdueshëm i qytetarëve për cilësinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike ka shumë rëndësi për vazhdimësinë e përmirësimit të performancës së administratës.

Në këtë kontekst, Sondazhi i Opinioni synon të përcaktojë nivelin e kënaqshmërisë së publikut në 12 muajt e fundit me shërbimet publike që ofrohen nga një sërë institucionesh publike. Shërbimet e zgjedhura publike janë ato që qytetarët i marrin çdo ditë (p.sh. transporti publik, furnizimi me ujë) apo shumë shpesh (si kujdesi shëndetësor, shërbimi i pastrimit) të ofruara nga qeveria qendrore dhe ajo vendore.

Në mënyrë të veçantë, pyetjet u fokusuan në kënaqshmërinë me shërbimet publike (p.sh. kujdesi shëndetësor, arsimi, transporti publik, apo policia) dhe paraqitja e ankesave kur shërbimet nuk përmbushin pritshmëritë. Të anketuarve iu kërkua të krahasojnë cilësinë e shërbimeve sociale në bashkinë e tyre të vitit 2018 me ato të vitit 2017. Së fundi, të intervistuarve iu kërkua të thonin nëse ndjeheshin të sigurt në jetën e përditshme dhe cilët mund të ishin faktorët që i bënin të ndjeheshin të pasigurt.

• • • • •

18 Për më shumë informacioni për ekonominë e Shqipërisë vizitoni adresën: <http://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>.


19 Shih <http://documents.worldbank.org/curated/en/685021468015003609/pdf/WPS5994.pdf>

Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

Shumica e shërbimeve publike që ofrohen në Shqipëri, si shërbimi i punësimit, kujdesi shëndetësor apo policia, nuk janë të kënaqshme sipas qytetarëve shqiptarë. Megjithatë, të anketuarit e punësuar në sektorin publik dhe pensionistët janë më të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike sesa të anketuarit e tjerë.

Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin 13 shërbime të ndryshme publike sipas një shkalle, që varionte nga “shumë i kënaqur” në “shumë i pakënaqur”. Të dhënat sugjerojnë se vetëm për dy shërbime publiku ishte shpesh i kënaqur me shërbimin e ofruar; furnizimi me ujë të pijshëm (50% të kënaqur përkundër 48% të pakënaqur) dhe sistemin arsimor (40% të kënaqur përkundër 47% të pakënaqur). Të intervistuarit janë veçanërisht të pakënaqur me shërbimin e punësimit (74%), shërbimet gjyqësore (62%), shërbimet sociale (59%), transportin publik (57%) dhe sistemin e kujdesit shëndetësor (57%).

Grafiku 48. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2018



Secili pjesëmarrës në këtë sondazh u pyet nëse kishte përftuar një shërbim të caktuar. Kjo na bën të mundur të vlerësojmë nëse njerëzit që kanë përftuar një shërbim të caktuar publik janë të kënaqur me shërbimin e ofruar. Shërbimet publike të përdorura më shpesh janë: shërbimet shëndetësore, furnizimi me ujë të pijshëm, transporti publik, pastrimi i rrugëve dhe arsimit.

Të anketuarit kishin më shumë gjasa të raportonin se ishin të kënaqur me transportin publik (41%), shërbimet sociale (38%), pastrimin e rrugëve (53%) dhe furnizimin me ujë të pijshëm (53%), kur kishin marrë shërbime, sesa ata që nuk i kishin marrë këto shërbime. Përkundrazi, për shërbimet e kujdesit shëndetësor, punësimin, licencimin e bizneseve, regjistrimin e pronave, lejet e ndërtimit dhe shërbimet gjyqësore, të anketuarit që i kishin përdorur këto shërbime ishin më pak të kënaqur sesa ata që nuk i kishin përdorur këto shërbime në vitin 2018. Për shërbimin e arsimit, emergjencat dhe policinë dallimet që u vunë re ishin mjaft të vogla.

Tabela 15. Përdorimi dhe kënaqësia me shërbimet publike 2018

	Niveli i kënaqshmërisë – nuk u përdor shërbimi	Niveli i kënaqshmërisë – u përdor shërbimi	Përdorimi i shërbimit
Shërbimet e shëndetit publik	44%	40%	81% (n = 1,260)
Shërbimet e arsimit publik	52%	50%	60% (n = 928)
Transporti publik	30%	41%	77% (n = 1,180)
Shërbimet sociale	29%	38%	48% (n = 730)
Shërbimet e punësimit	21%	17%	48% (n = 737)
Shërbimet e emergjencave	49%	47%	35% (n = 540)
Shërbimet e pastrimit të rrugëve	41%	53%	68% (n = 1,045)
Furnizimi me ujë të pijshëm	39%	53%	81% (n = 1,249)
Licencimi, lejet, regjistrimi i bizneseve	45%	37%	26% (n = 376)
Shërbimet e hipotekës	34%	28%	34% (n = 497)
Lejet e ndërtimit	35%	22%	25% (n = 357)
Gjykatat dhe shërbimet e institucioneve të gjyqësorit	25%	18%	22% (n = 321)
Shërbimet e policisë	44%	47%	33% (n = 478)

Është me interes të evidentohet se të anketuarit që punojnë në sektorin publik raportojnë shpesh se janë të kënaqur me shërbimet publike krahasuar me ato të punësuar në sektorin privat. P.sh. nga të anketuarit që punojnë në sektorin publik, 56% raportuan se ishin të kënaqur me kujdesin shëndetësor krahasuar me 41% të totalit të të anketuarve. Për arsimin, 70% e të anketuarve që punonin në sektorin publik ishin të kënaqur krahasuar me 50% të totalit të të anketuarve. Ky konstatim vlen pothuajse për të gjitha shërbimet, përfshirë edhe shërbimin social (52% e të anketuarve që punojnë në sektorin publik janë të kënaqur, përkundër 31% të totalit të të anketuarve), shërbimin e punësimit (42% përkundër 17%), emergjencat civile (67% përkundër 44%), pastrimi i rrugëve (62% përkundër 49%), furnizimi me ujë të pijshëm (46% përkundër 26%), lejet e ndërtimit 44% përkundër 24%), shërbimet gjyqësore (37% përkundër 19%) dhe shërbimet e policisë (61% përkundër 40%).

Edhe pensionistët priren më shumë të jenë pozitivë për shërbimet publike. Për shërbimin e mirëqenies sociale, 44% e të anketuarve pensionistë janë pozitivë, krahasuar me 31% të totalit të popullatës së anketuar. Për shërbimin e emergjencave, 56% e pensionistëve janë të kënaqur me shërbimin krahasuar me 44% të totalit të popullatës së anketuar. Kjo tendencë vazhdon me shërbimin e pastrimit të rrugëve (64% përkundër 49%), shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm (61% përkundër 50%), dhe transportin publik (51% përkundër 37%). Përgjigja pozitive e të anketuarve pensionistë mund të ndikohet nga fakti se shumica e pensionistëve përfitojnë nga ulja e taksave apo asistencë financiare e ofruar nga qeveria dhe se ata lejohen të udhëtojnë pa pagesë në transportin publik.

Të anketuarit e papunë ishin shumë të pakënaqur me shërbimin e punësimit. Plot 90% e tyre thanë se ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me shërbimin e punësimit në Shqipëri krahasuar me 74% të totalit të të anketuarve. Për më tepër, të anketuarit me arsim të lartë (me diplomë Bachelor ose më të lartë) prireshin më shumë të ishin të kënaqur me arsimin (61%), krahasuar me të intervistuarit me më pak arsim (45%). Së fundi, studentët janë shpesh më të kënaqur me sistemin gjyqësor (42%) se të anketuarit e tjerë.

Në përgjithësi, të anketuarit nga bashkitë e mëdha janë më të pakënaqur se të tjerët me shërbimet publike. Pakënaqësia e tyre lidhet veçanërisht me transportin publik, shërbimin e emergjencave, pastrimin e rrugëve, furnizimin me ujë të pijshëm, lejet e ndërtimit dhe policinë. Për disa nga këto shërbime (si policia, lejet e ndërtimit dhe emergjencat), edhe të anketuarit nga bashkitë e vogla ndajnë të njëjtin shqetësim dhe nivel të lartë të pakënaqësisë. Po ashtu, në bashkitë e vogla, niveli i pakënaqësisë është më i lartë se në bashkitë e tjera për sa i përket kujdesit shëndetësor, hipotekave, dhe mjedisit të biznesit (regjistrimi dhe licencimi).


Krahasuar me 2017 dhe 2016, për vitin 2018 niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet publike ka pësuar rënie. Në 2016, qytetarët ishin përgjithësisht të kënaqur me 6 shërbime publike që u përfshinë në këtë sondazh. Përgjigje pozitive u dhanë për furnizimin me ujë të pijshëm (72%), policinë (60%), pastrimin (58%), emergjencat (55%), dhe transportin publik (55%). Në vitin 2017, qytetarët ishin përgjithësisht të kënaqur me 6 shërbime publike që u përfshinë në këtë sondazh, pra: furnizimi me ujë të pijshëm (56%), pastrimin (57%), emergjencat (53%), dhe arsimi (54%). Në 2018, asnjë nga shërbimet publike të përfshira në sondazh nuk e kaloi nivelin e kënaqshmërisë prej 50%.

Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve sociale të ofruar në bashki

Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e të anketuarve nuk shohin ndryshime në cilësinë e shërbimeve sociale të ofruara në nivel bashkie. Vetëm të anketuarit që punojnë në sektorin publik shohin ndryshime në cilësinë e shërbimeve sociale: 50% mendojnë se cilësia është më e mirë në 2018 sesa në 2017.

Të gjithë pjesëmarrësit u pyetën “Si e vlerësoni cilësinë e shërbimeve sociale të ofruara në bashkinë tuaj në 2018 krahasuar me 2017?”. Shumica e të anketuarve (56%) raportuan se cilësia e shërbimeve të ofruara nga bashkia nuk kishte ndryshuar. 28% thanë se cilësia e këtyre shërbimeve ishte përmirësuar dhe sipas 16% e të intervistuarve cilësia e shërbimeve që kishte ofruar bashkia e tyre ishte përkeqësuar kur bëhej krahasimi me një vit më parë.

Grafiku 49. Ndryshimet në cilësinë e shërbimeve sociale 2018



Baza: N = 1617

Sipas analizës demografike nuk u vunë re dallime për nga mosha, gjinia, vendbanimi apo statusi i punësimit. Megjithatë, 50% e të anketuarve që punojnë në sektorin publik dhe 43% e atyre me arsim të lartë shpesh mendojnë se cilësia e shërbimeve sociale në bashkinë e tyre ishte përmirësuar në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.

Paraqitja e ankesave

Të dhënat e sondazhit tregojnë se të anketuarit nuk i paraqesin ankesat e tyre tek institucioni ku morën shërbimin. Përkundrazi, ata kanë filluar të përdorin platformën e bashkëqeverisjes që u krijua në vitin 2017.


Të anketuarit u pyetën se nëse do të bënin ndonjë ankesë apo sugjerim në lidhje me shërbimet publike, ku do ta bënin atë.

Pyetje: 'Nëse do të kishit një sugjerim apo ankesë për shërbimet, ku do e drejtonit?'

Një numër i madh të anketuarish thanë se nuk ishin të sigurt se ku do ta bënin ankesën e tyre. Ata që përmendën institucione përmendën shpesh se do ta bënin ankesën në bashki, qeveri (si term i përgjithshëm), polici, kryeministri ose do ta raportonin ankesën tek media. Disa të anketuar madje përmendën programe të njohura investigative, si Fiks Fare (Top Channel) apo Stop (TV Klan). Vetëm një numër i vogël të anketuarish përmendën zyrën e ankesave (zyrën e ankesave të përgjithshme dhe zyrën e ankesave që lidhet me institucionin që ofroi shërbimin) ose Avokatin e Popullit, zyrat që kanë përgjegjësinë e trajtimit të ankesave të qytetarëve.

Gjatë vitit 2018, 11% e të anketuarve thanë se kishin bërë një ankesë për një shërbim që kishin marrë në një nga institucionet e mësipërme. Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç nuk kishin gjasa të bënin ndonjë ankesë: vetëm 4% thanë se kishin bërë ankesë në 2018.


Grafiku 50. A keni paraqitur ndonjë ankesë tek institucionet e ofrimit të shërbimeve 2016 - 2018



Baza: 2016, N = 1627; 2017, N = 1639; 2018, N = 1628

Në vitin 2017, u krijua një platformë e re online e quajtur Platforma e Bashkëqeverisjes, ku qytetarët mund të drejtojnë çdo ankesë që kanë, përfshirë këtu ato për shërbimet publike. Në vitin 2018, 10% e të anketuarve kishin përdorur këtë platformë, ku raportonin ankesat e tyre për shërbimet publike ose gjëra të tjera.

Grafiku 51. A keni bërë ndonjë ankesë tek Platforma e Bashkëqeverisjes?




Baza: N = 1536

Marrja e reagimit nga qeveria

Sipas të dhënave të sondazhit, ankesat që qytetarët kanë bërë për një shërbim që kishin marrë ishte trajtuar më shpesh në 2018 se në vitet e mëparshme. Pavarësisht këtyre rezultateve pozitive, të anketuarit kanë një ndjesi në rritje sikur institucionet nuk i dëgjojnë dhe nuk i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve.

Të anketuarit që kishin bërë ankesa, qoftë tek institucionet përkatëse ose nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, u pyetën për trajtimin e mëtejshëm të ankesës së bërë. Sipas të anketuarve në 2018, gjysma e ankesave të paraqitura ishin trajtuar. 25% raportuan se ankesa e tyre nuk ishte trajtuar dhe një tjetër 25% thanë se nuk ishin të sigurt se çfarë kishte ndodhur me ankesën e tyre.

Grafiku 52. A u trajtua ankesa juaj? 2016-2018




Baza: 2016, N = 252; 2017, N = 241; 2018, N = 170

Krahasuar me një vit më parë, u trajtuan një përqindje në rritje e ankesave. Në 2016, vetëm 33% e ankesave ishte trajtuar, krahasuar me 37% në 2017 dhe 50% në 2018.

Edhe pse shumica e të anketuarve thanë se ankesat e tyre ishin trajtuar, është me rëndësi nëse publiku në përgjithësi ndjen se dëgjohet zëri i tij. Për këtë arsye, të gjithë të anketuarit u pyetën: “A mendoni se institucionet “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët?” 46% raportuan se institucionet nuk i dëgjojnë ankesat e qytetarëve dhe nuk i trajtojnë ato siç duhet. 31% nuk janë të sigurt nëse institucionet publike punojnë mirë në trajtimin e problematikave dhe vetëm 23% thanë se institucionet i dëgjojnë dhe i trajtojnë ankesat e qytetarëve.

Grafiku 53 . A mendoni se institucionet “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët?



Baza: 2016, N = 1259; 2017, N = 1599; 2018, N = 1565


Në mënyrë të veçantë, të anketuarit që punojnë në sektorin privat kishin më shumë gjasa (55%) të raportonin se institucionet nuk i dëgjojnë dhe nuk i trajtojnë ankesat e qytetarëve. Krahasuar me vitet e kaluara, të anketuarit janë më pesimistë për vullnetin e institucioneve për të dëgjuar dhe trajtuar siç duhet ankesat e qytetarëve. Në 2016, 28% besonin se institucionet i dëgjojnë dhe nuk i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve dhe në 2017 kjo përqindje ishte 29%.

Siguria

Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e shqiptarëve ndjehen të pasigurt në jetën e përditshme. Arsyet më shpesh të cituara për këtë ndjenjë pasigurie janë krimi, pasiguria e punës dhe shëndetësia pa cilësi dhe standard.

Siguria ekonomike dhe siguria fizike janë tregues të rëndësishëm për cilësinë e jetës. Eurostat, zyra e statistikave të BE-së, ka identifikuar sigurinë fizike dhe ekonomike si një nga nëntë treguesit bazë për të përcaktuar cilësinë e jetës në vendet anëtare të BE-së (Eurostat, 2018)²⁰. Kështu, në këtë sondazh të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt në jetën e tyre të përditshme. 41% e tyre thanë se ndjehen të sigurt në jetën e përditshme, krahasuar me shumicën prej 59% që thanë se nuk ndjehen të sigurt në jetën e përditshme. Në 2017, 51% e të anketuarve thanë se ndjehen të sigurt në jetën e përditshme dhe në 2016 kjo shifër ishte 49%.

Grafiku 54. Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme 2016 - 2018



Baza: 2016, N = 1608; 2017, N = 1615; 2018, N = 1629

.....

20 See Eurostat Quality of life indicators: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Quality_of_life_indicators

Të anketuarit që punojnë në sektorin publik (50%), pensionistët (57%), apo ata të moshës mbi 65 vjeç (60%) ishin më të prirur të raportonin se ndjehen të sigurt në jetën e përditshme në krahasim me të anketuarit e tjerë. Nga ana tjetër, të intervistuarit që janë të papunë ishin më pak të prirur për të raportuar se ndjehen të sigurt në jetën e përditshme (33%).

Të anketuarit që u përgjigjën se nuk ndjehen të sigurt në jetën e përditshme u pyetën se cilët ishin faktorët kryesorë i bëjnë të ndjehen të pasigurt. Shumica e tyre thanë se krimi (71%), pasiguria e punës (52%) dhe shëndetësia pa cilësi dhe standard (50%) ishin probleme të jetës së përditshme. Faktorë të tjerë të cituar shpesh janë edhe padrejtësia dhe politika.

Tabela 16. Faktorët kryesorë që shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë

Faktorët kryesorë	2018	2017	2016
Kriminaliteti (vjedhjet, grabitjet)	71% (n = 689)	58%	49%
Trafiku	13% (n = 123)	11%	7%
Ndotja	20% (n = 488)	12%	3%
Shëndetësia pa cilësi e standard	50% (n = 242)	30%	11%
Përdorimi i lëndëve narkotike	29% (n = 283)	23%	6%
Pasiguria për punën	52% (n = 503)	42%	N/A
Dhuna në familje	19% (n = 184)	15%	3%
Padrejtësia	45% (n = 235)	32%	11%
Politika	45% (n = 434)	29%	5%
Pabarazia në pasuri	23% (n = 228)	23%	3%
Diskriminimi në bazë të gjinisë, besimit fetare, pasurie dhe aftësie sociale	7% (n = 69)	5%	N/A
Mungesa e lirisë së fjalës	11% (n = 111)	5%	1%
Mungesa e konfidencialitetit dhe mbrojtjes kur raportohen shkeljet	12% (n = 118)	6%	1%

Baza: N = 1647

Shënim: Lejohen disa përgjigje; Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet mund të mos jenë 100 %

Krahasuar me vitet e kaluara, pothuajse të gjithë faktorët e ndjenjës së pasigurisë janë raportuar më shpesh. Duhet theksuar se në 2018 një numër më i madh të anketuarish (krahasuar me vitet e kaluara) deklaruan se krimi, shëndetësia pa cilësi e standard, pasiguria për punën, padrejtësia, politika dhe ndotja janë probleme të jetës së përditshme. Megjithatë, ajo që është më shumë shqetësuese është se të anketuarit raportojnë si problem mungesën e konfidencialitetit dhe mbrojtjes në rast denoncimi të shkeljeve, numër që po rritet çdo vit.

Shqiptarët raportojnë më shpesh se ndjehen të pasigurt për shkak të krimit (të rrugës); 42% (689 nga 1647) ndjehen të pasigurt në jetën e përditshme për shkak të frikës nga krimet, si vjedhjet apo grabitjet. Në vendet e BE-së vetëm 12% e qytetarëve mendojnë se ka ‘krime, dhunë apo vandalizëm në zonën ku jetojnë’²¹.

4.7 Performanca e institucioneve publike

Për të matur performancën e institucioneve publike në Shqipëri, të anketuarve iu kërkua që të rendisnin 11 institucione në një shkallë që fillon me 1 (performancë e shkëlqyer) në 5 (performancë shumë e dobët). Për një pjesë të konsiderueshme, të anketuarit nuk ishin të kënaqur me performancën në përgjithësi të institucioneve. Vlerësim negativ marrin në mënyrë të veçantë gjykatat, Prokuroria dhe Parlamenti. 66% e të anketuarve e vlerësojnë performancën e gjykatave si negative (të dobët ose shumë të dobët). Performanca në përgjithësi e Prokurorisë ishte po aq zhgënjyese; 64% e të anketuarve e vlerësuan atë si të dobët ose shumë të dobët. 59% e të intervistuarve e vlerësuan performancën e Kuvendit si të dobët ose shumë të dobët.

Institucionet publike me performancën më të mirë, sipas të anketuarve të sondazhit, ishin institucionet fetare (43% “të shkëlqyer” ose “shumë të mirë”), ushtria (34% “të shkëlqyer” ose “shumë të mirë”) dhe policia (30% “të shkëlqyer” ose “shumë të mirë”). Shumë të anketuar dhanë përgjigje neutrale për pyetjen: “Për vitin 2018, si e vlerësoni kryerjen e funksioneve kryesore të institucioneve që do ju rreshtoj në një shkallë nga 1 (të shkëlqyer) në 5 (shumë të dobët)?”

Tabela 17. Performanca e institucioneve (në përqindje)

	Të shkëlqyer		Shumë të mirë		Neutral		Të dobët		Shumë të dobët		Refuzim
	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Qeveria qendrore	3	4	19	24	29	27	34	31	15	15	1
Qeveria vendore (Bashkia)	3	4	20	28	34	28	29	29	14	11	<1
Presidenti	1	2	9	12	39	37	36	37	15	12	1
Parlamenti	1	2	8	11	32	33	40	39	18	16	1

• • • • •

21 For more information on economic and physical safety in the European Union, see: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Quality_of_life_indicators_-_economic_and_physical_safety#General_overview

	Të shkëlqyer		Shumë të mirë		Neutral		Të dobët		Shumë të dobët		Refuzim
	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Prokuroria	1	1	8	7	26	24	42	43	22	26	1
Gjykatat	1	1	8	6	24	21	42	42	23	30	1
Policia	4	5	26	24	34	30	24	28	12	12	1
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	2	3	10	17	46	52	22	21	13	7	8
Institucionet fetare	13	19	30	38	34	33	11	7	5	4	8
Ushtria	9	10	25	36	41	38	13	11	6	5	7
Partitë Politike	2	2	8	11	26	30	36	37	25	20	3

Baza: N = 1633, N = 1636, N = 1634, N = 1634, N = 1632, N = 1635, N = 1635, N = 1627, N = 1626, N = 1626, N = 1627

Krahasuar me vitin 2017, institucionet publike konsiderohen përherë e më pak si me “performancë të mirë”. Të anketuarit japin vlerësime të përgjithshme negative në mënyrë të veçantë për institucionet fetare, qeverisjen vendore, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe qeverinë qendrore. Të anketuarit e Sondazhit të Opinioneve të vitit 2017 i vlerësuan më shpesh këto institucione si pozitive (“të shkëlqyer” ose “shumë të mirë”). Ushtria humbi 22 pikë përqindje (p.p.) të vlerësimit pozitiv, institucionet fetare 14 p.p., qeverisja vendore 9 p.p., KQZ 8 p.p. dhe qeveria qendrore 6 p.p. Gjykatat, Prokuroria dhe policia morën përgjithësisht një vlerësim paksa më të mirë.

Të anketuarit nga bashkitë e vogla e të mesme tregojnë përqindje më të larta të vlerësimeve negative për performancën e institucioneve. Të intervistuarit nga bashkitë e vogla kanë qëndrim më kritik se të anketuarit e tjerë kur vjen puna për performancën qeverisë qendrore, Prokurorisë, gjykatave, policisë, institucioneve fetare dhe ushtrisë. Në bashkitë e mesme, të anketuarit janë ë kritikë me performancën e partive politike, Presidentit dhe bashkive. Të intervistuarit nga qendrat e mëdha urbane – bashkitë e mëdha me mbi 100,000 banorë për bashki, priren të tregojnë përqindje më të larta të vlerësimeve pozitive për performancën e institucioneve gjatë vitit 2018.


Donatorët e huaj në Shqipëri

Një temë që ka marrë vëmendje në këto vitet e fundit është prania e donatorëve të huaj në shtetet që duan të bëhen anëtare të BE-së. Në këtë kontekst, donatorët e huaj ofrojnë asistencë për ngritje kapacitetesh dhe ndihmojnë vendet që aspirojnë të bëhen anëtare

të BE-së në përcaktimin e standardeve për cilësinë e infrastrukturës, sistemit të shëndetit publik dhe shërbimeve të tjera publike.

Për këtë qëllim, të anketuarve iu bë pyetja sa të kënaqur janë me ndikimin e asistencës së huaj (donatorët) në Shqipëri. 58% e të anketuarve ishin të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj në Shqipëri, ndërsa 42% nuk ishin të kënaqur.

Grafiku 55. Kënaqshmëria me ndikimin e asistencës së huaj (donatorët) në Shqipëri



Baza: N = 1546

4.8 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Dixhitalizimi i shërbimeve është tendencë në të gjithë botën në shekullin e ri. Përdorimi i TIK ndihmon që veprimtaria e qeverisë të bëhet më e aksesueshme, efikase dhe transparente. Me disa klikime, qytetarët mund të marrin dokumente sipas dëshirës në shtëpi apo vende të tjera. Një tjetër avantazh i portaleve të qeverisjes elektronike është se ky sistem e bën procesin e ofrimit të shërbimeve më objektiv dhe më pak të cenueshëm nga korrupsioni (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, 2018)²². Eliminimi i ndërveprimit me njerëzit në proceset e qeverisë pakëson mundësitë e ryshfetit dhe formave të tjera të korrupsionit.

Që nga viti 2012, Shqipëria ka një platformë online që ofron shërbimet bazë qeveritare. Në platformën e-Albania qytetarët mund të aplikojnë për leje drejtimi ose për universitet dhe të shkarkojnë një sërë certifikatash. Në 2018, portali ofronte mbi 500 shërbime elektronike

.....

22 Shih p.sh. këtë raport nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, që gjendet në adresën https://www.giz.de/de/downloads/giz2018-eng_ICT-to-strengthen-Anti-Corruption.pdf


ndërkohë që numri i përdoruesve të regjistruar i kaloi shifrën prej 0.5 milionë.²³ Në këtë seksion, të anketuarit u përgjigjen disa pyetjeve për faqen e internetit të bashkisë së tyre dhe shërbimet online të institucioneve të qeverisjes vendore dhe qendrore.

Faqja e internetit e bashkisë

Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e shqiptarëve nuk janë në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe interneti. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit e moshës dhe ata në pension kishin fare pak njohuri për faqen online të bashkisë së tyre. Nga të anketuarit që janë në dijeni të faqes së internetit të bashkisë, vetëm 1/3 e tyre e përdorin faktikisht atë.

Në ditët e sotme, pjesa më e madhe e bashkive kanë një faqe interneti që ofron informacione për strukturën organizative, buxhetin e bashkisë, vendimet e këshillit bashkiak për bashkinë, etj. Nga të anketuarit, 38% ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte faqe interneti. Shumica e të anketuarve nuk e dinin se bashkia e tyre kishte faqe interneti (53%) dhe 9% u përgjigjen se bashkia e tyre nuk ka faqe interneti.

Grafiku 56. A e dini nëse Bashkia juaj ka një faqe interneti?



Baza: N = 1638


Të anketuarit nga qendrat urbane ishin më të prirur të përgjigjeshin se e dinin që bashkia e tyre kishte faqe interneti (46%) krahasuar me ata nga zonat rurale (31%). Të anketuarit e punësuar në sektorin publik (68%), studentët (67%) apo të intervistuarit me arsim të lartë

.....

23 Për informacione dhe lajme të tjera në portalin e-Albania shih <https://e-albania.al/Pages/News.aspx>.

(69%) prireshin më shumë të raportonin se e dinin që bashkia e tyre kishte faqe interneti. Nga ana tjetër, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç nuk kishin dijeni se bashkia e tyre kishte faqe interneti. Vetëm 10% e këtij grupi iu përgjigj “Po” kësaj pyetjeje.

Grafiku 57. A e dini nëse Bashkia juaj ka një faqe interneti? 2015-2018




Baza: 2015, N = 1565; 2016, N = 1618; 2017, N = 1640; 2018, N = 1638.

Vlen për t’u theksuar se përqindja e të anketuarve që raportojnë se e dinë që bashkia e tyre ka faqe interneti ka pësuar rënie – nga 43% në 2015 në 38% në 2018.

Nga të anketuarit që në 2018 u përgjigjën se e dinë që bashkia e tyre kishte faqe interneti, vetëm 35% thanë se e përdorin këtë faqe interneti. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit që punojnë në sektorin publik (57%) apo ata me arsim të lartë (48%) ishin më të prirur të raportonin se përdornin faqen e internetit të bashkisë së tyre.

Grafiku 58. A e përdorni faqen e internetit të bashkisë?



Baza: N = 624

Përdorimi i faqes së internetit të bashkisë dhe vlerësimi i cilësisë

Sipas të dhënave të sondazhit, pjesa më e madhe e të anketuarve e përdorin faqen e internetit të bashkisë për të marrë informacione për aktivitete apo programe ose për të kontrolluar cilat shërbime ofrohen. Në tre vitet e fundit, shumica e të anketuarve e vlerësuan faqen e bashkisë së tyre si të saktë, të përditësuar vazhdimisht dhe të pasur me informacione.

Të anketuarit që përdorin faqen e bashkisë e bëjnë këtë për të marrë informacione për programe ose aktivitete në bashkinë/qytetin ku jetojnë (14%), për të marrë informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen ato (12%). Një numër më i vogël të anketuarish e përdorin faqen e internetit të bashkisë për të parë vendimet e këshillit bashkiak (5%) ose për të dërguar ankesa, komente te një drejtori / staf bashkiak (4%).


Tabela 18. Mënyrat e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë

Për të marrë informacione (Kontrolloj programet/aktivitetet në bashkinë time)	14% (n = 115)
Ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve	5% (n = 41)
Dërgoj ankesa, komente te një drejtori / staf bashkiak	4% (n = 29)
Për të marrë informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen	12% (n = 102)
Tjetër*:	1% (n = 7)

**Tjetër: Për të marrë informacione për biznesin tim, për të mbaruar një detyrë për shkollën/universitetin*

Pjesa më e madhe e të anketuarve e vlerësojnë cilësinë e faqes së internetit për sa i përket informacionit të ofruar si: të saktë (87%), të plotë (62%) dhe të përditësuar vazhdimisht (69%). Në vitin 2017, të anketuarit dhanë përgjigje duke evidentuar përqindje pak më të larta: 91% raportuan se informacioni në faqen e internetit ishte i saktë, 79% i plotë, 72% i përditësuar vazhdimisht (72%).

Grafiku 59. Cilësia e informacionit në faqen e internetit të bashkisë 2016-2018




Baza: 2016, N = 266; 2017, N = 205; 2018, N = 205.

E-Qeverisja në Shqipëri

Të dhënat tregojnë se shumica e të anketuarve janë në dijeni të shërbimeve të e-qeverisjes në vend. Megjithatë, ka ende mungesë ndërgjegjësimi për të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç. Portali e-Albania perceptohet si funksional dhe i lehtë për t'u përdorur.

Me zgjerimin gradual të portalit e-Albania, shqiptarët po përdorin përherë e më shumë platformën për të shkarkuar dokumente apo për të aplikuar për shërbime publike. Gjysma e të anketuarve (54%) ishin në dijeni se që qeveria (administrata) ofronte shërbime elektronike përmes portalit E-Albania. Është e kuptueshme se studentët janë në dijeni të portalit (83%), sepse ata e kanë përdorur atë për t'u regjistruar për në universitet. Edhe të anketuarit që punojnë në sektorin publik (76%) dhe të anketuarit me të paktën diplomë universitare (79%) ishin në dijeni për portalin e-Albania. Nga ana tjetër, të intervistuarit në pension (23%) dhe të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç kishin shumë pak dijeni për portalin e-Albania.


Grafiku 60. A jeni në dijeni që qeveria (administrata) ofron shërbime elektronike përmes portalit E-Albania?



Baza: N = 1622


Nga të anketuarit që kanë përdorur portalin e-Albania, 47% kishin marrë shërbime elektronike gjatë vitit 2018. Të anketuarit që punojnë në sektorin publik (62%) apo ata me nivel të lartë arsimi (60%) kanë marrë shërbime nëpërmjet portalit e-Albania.

Grafiku 61. A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania?



Baza: N = 872

Të anketuarit që kanë marrë shërbime elektronike gjatë 2018 ishin shumë pozitivë për cilësinë e shërbimeve elektronike në portalin e-Albania. 94% raportuan se shërbimet elektronike ishin funksionale, 76% evidentuan se shërbimet ishin të lehta për t'u përdorur dhe 72% thanë se shërbimet elektronike u japin qytetarëve mundësinë të bëjnë komente apo sugjerime.

Grafiku 62. Si do e vlerësonit cilësinë e shërbimeve elektronike të portalit e-Albania?

Baza: N = 412, N = 407, N = 407

4.9 Gjinia dhe përfshirja sociale

Shoqëria shqiptare karakterizohet nga një ndarje tradicionale e roleve gjinore, ku gratë kujdesen për shtëpinë kurse burrat sjellin të ardhurat për familjen. Veçanërisht në familjet me shumë fëmijë apo në familjet në zonat rurale, janë gratë ato që bëjnë larjen dhe hekurosjen e rrobave, pastrimin e shtëpisë, gatimin dhe larjen e enëve (Dauti and Zhllima, 2016)²⁴. (Në zonat urbane dhe tek çiftet që kanë emigruar më parë, kjo ndarje e punëve po ndryshon. Vajzat po ndjekin përherë e më shumë studimet universitare, deri në atë pikë sa në këto vitet e fundit numri i femrave që ndjekin universitetin është më i madh se ai i meshkujve (INSTAT, 2018, p. 49)²⁵.

Po ashtu, janë ndërmarrë disa nisma për të nxitur përfshirjen e femrave në proceset e vendimmarrjes, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Një gjë e tillë ka sjellë rezultate. Në Tiranë, p.sh., numri i femrave në këshillin bashkiak është më i madh se ai i meshkujve. Pas nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Shoqërore në 2017, në 5 bashki në Shqipëri është miratuar Plani i Veprimit i Barazisë Gjinore (UN Women, 2018)²⁶.

.....

24 Dauti, M. and Zhllima, E. (2016). Public Perceptions and Attitudes toward Gender Equality in Albania. Tirana:UNDP. http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/STUDIMI_PERCEPTIMET_eng.pdf

25 Shih raportin 'Gratë dhe burrat në Shqipëri, 2018' by INSTAT, p. 49.

26 Lajmet dhe ngjarjet në UN Women, 29 qershor 2018. Shih <http://eca.unwomen.org/en/news/stories/2018/06/for-the-first-time-in-albania-cities-adopt-gender-equality-action-plans>


Perceptimet për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare

Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e shqiptarëve mendojnë se në Shqipëri ka barazi mes burrave dhe grave. Meshkujt prirën të jenë dakord më shumë me këtë pohim sesa femrat.

Pohimi 1: “Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave”

Për të nxjerrë në pah qëndrimet ndaj barazisë gjinore, të anketuarve iu bënë një sërë pyetjesh për barazinë gjinore, diskriminimin dhe përfshirjen sociale në Shqipëri. Së pari, të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për tre pohimet për barazinë gjinore. Për pohimin “barazisë gjinore” 55% e të intervistuarve ishin dakord ose plotësisht dakord.

Grafiku 63. Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave




Baza: N = 1636

Të anketuarat femra prirën të mos jenë dakord (39%) ose aspak dakord (10%) me pohimin në krahasim me meshkujt (31% dhe 8% respektivisht). Kjo sugjeron se gratë janë disi dyshuese për barazinë mes gjinive në Shqipëri. Kur këto përgjigje analizohen në aspektet demografike, të dhënat tregojnë se të anketuarit mbi 65 vjeç (65%) janë më shumë dakord me pohimin sesa ata të moshës 19 dhe 25 vjeç (50%) ose të grupmoshës 26-35 vjeç (52%). Për më tepër, të anketuarit e punësuar (60%) prirën të jenë më shumë dakord me pohimin sesa të anketuarit që janë të papunë (48%).

Është me interes të evidentohet se të anketuarit në zonat rurale prirën të jenë më shumë dakord me pohimin (57%) në krahasim me ata të zonave urbane (54%), ndërkohë që përgjithësisht presupozohet se rolet tradicionale gjinore janë më shumë të pranishme në zonat rurale sesa ato urbane.

Në vitin 2016, 55% e burrave dhe 39% e grave ishin dakord ose plotësisht dakord se në Shqipëri ka barazi mes burrave dhe grave. Në 2017, këto përqindje ishin 71% dhe 60% respektivisht. Krahasuar me 2018, në të cilën përqindjet ishin 59% për të anketuarit meshkuj dhe 51% e të anketuarve femra, duket se kemi një rritje të konsiderueshme në perceptimin për barazinë gjinore në 2017. Këtë vit, të anketuarit janë më pak optimistë për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare.

Grafiku 64. Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave 2016-2018




Baza: 2016, N = 1636; 2017, N = 1623; 2018, N = 1636

Aksesi dhe marrja e shërbimeve publike

Shumica e të anketuarve raportojnë se në Shqipëri gratë dhe burrat kanë akses të njëjtë tek shërbimet publike dhe se nëpunësit publikë i shërbejnë grave dhe burrave me të njëjtin përkushtim dhe etikë. Gratë ishin më pak të prirura të binin dakord me këtë pohim krahasuar me burrat, gjë që sugjeron se gratë perceptojnë më pak se burrat dhe burrat kanë akses të njëjtë tek shërbimet publike dhe se trajtohen njësoj nga nëpunësit publikë.

Pohimi 2: “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”

Për pohimin “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”, 69% e të anketuarve ishin dakord me këtë pohim, ndërkohë që vetëm 7% e të anketuarve nuk ishin aspak dakord. Të anketuarit meshkuj priren të raportojnë më shumë se gratë dhe burrat kanë akses të barabartë tek shërbimet publike. 71% e të anketuarve meshkuj janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim krahasuar me 67% të femrave që kanë të njëjtin qëndrim.

Grafiku 65. Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike

Baza: N = 1624


Të anketuarit që banojnë në zonat rurale janë dakord me këtë pohim paksa më shumë (72%) se ata që jetojnë në zonat urbane (68%). Të anketuarit e punësuar (74%) apo të intervistuarit në pension (74%) prireshin më shumë të raportonin se në Shqipëri burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike në krahasim me të anketuarit e papunë (65%) dhe studentët (69%). Pjesëmarrësit e këtij sondazhi që janë në marrëdhënie pune në sektorin publik priren të raportojnë (77%) se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike.

Nëse do të merrnim parasysh edhe moshën, të anketuarit e grupmoshës 56-65 vjeç (76%) priren më shumë të raportojnë se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike sesa të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç (60%). Së fundi, të anketuarit me diplomë të shkollës së mesme (73%) apo me universitet (71%) priren më shumë të raportojnë se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike në krahasim me të anketuarit me nivel më të ulët arsimimi (65%).

Duke parë përgjigjet e dhëna për këtë pohim dhe atë të mëparshëm, duket se banorët e zonave rurale mund ta kuptojnë ndryshe se ç'do të thotë barazi gjinore në një shoqëri moderne. Njohja fare e pakët e rolit udhëheqës të grave dhe burrave që marrin përsipër role përkujdesjeje mund të jenë shkaqet e ndërgjegjësimit të kufizuar për rolet alternative gjinore.

Krahasuar me vitet e kaluara, e njëjta tendencë vihet re edhe për pyetjen e mëparshme. Në vitin 2016, 63% e burrave dhe 55% e grave ishin dakord me pohimin. Në vitin 2017, këto përqindje ishin 79% dhe 71% respektivisht. Mes viteve 2016 dhe 2017 ka pasur një rritje të madhe tek gratë dhe burrat që mendojnë se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike, ndërkohë që kjo përqindje bie në 71% për burrat dhe 67% për gratë në 2018.

Grafiku 66. Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike 2016-2018




Baza: 2016, N = 1635; 2017, N = 1619; 2018, N = 1624

Pohimi 3: “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave”

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre për pohimin ‘Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave’. 69% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërkohë që 6% nuk ishin aspak dakord se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave. Burrat ishin më të predispozuar për të rënë dakord (50%) ose plotësisht dakord (22%) me këtë pohim krahasuar me gratë (46% dhe 20% respektivisht).

Grafiku 67. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave




Baza: N = 1636

Kur i analizojmë përgjigjet nga ana demografike, shohim dallime të vogla mes të anketuarve që jetojnë në zonat urbane dhe atyre të zonave rurale. Këta të fundit raportojnë paksa më shumë (72%) se të anketuarit e zonave urbane (70%) se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.

Njësoj si me pohimet e mëparshme, të punësuarit (73%) apo pensionistët (76%) ishin dakord me këtë pohim më shumë se të papunët (66%) apo të anketuarit studentë (66%). Të anketuarit që punojnë në sektorin publik kishin më shumë gjasa të raportonin (79%) se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin privat (70%).

Dallime evidentohen edhe në aspektin e nivelit arsimor dhe moshës, por tendencat nuk janë të dukshme. Në përgjithësi, të anketuarit e grupmoshave mbi 45 vjeç (74%, 77%, dhe 73%) priren të jenë më shumë dakord me këtë pohim krahasuar me kategoritë e moshës nën 45 vjeç (68%, 66% dhe 70%).

Grafiku 68. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave 2016-2018



Baza: 2016, N = 1635; 2017, N = 1614; 2018, N = 1636

Kur krahasojmë përgjigjet e vitit 2018 me ato të 2017 dhe 2016, shohim një tendencë të ngjashme si me pohimet e mëparshme, ku të anketuarit pyeten për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare dhe aksesin në shërbimet publike. Në vitin 2016, 66% e meshkujve dhe 56% e femrave ishin dakord me këtë pohim. Në 2017, këto përqindje ishin 80% dhe 69% përkatësisht dhe në 2018 ato ishin 71% (burrat) dhe 67% (gratë). Duket se mes viteve 2016-2017, përqindja e të anketuarve që japin përgjigje pozitive për këtë pohim është rritur dukshëm, ndërkohë që në 2018 kjo përqindje ka rënë.

Diskriminimi nga institucionet apo nëpunësit publikë

Të dhënat e sondazhit tregojnë se një shumicë e madhe e të anketuarve nuk janë trajtuar ndryshe nga institucionet në vitin 2018. Për ata të anketuar që janë trajtuar ndryshe, kjo ndodhte më shpesh për shkak të gjinisë.

Të anketuarve iu kërkua të shprehnin nëse ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të karakteristikave, si gjinia, mosha, përkatësia etnike dhe orientimi seksual. Një shumicë e konsiderueshme (83%) thanë se nuk ishin trajtuar ndryshe. Për ata të anketuar që janë trajtuar ndryshe, kjo ndodhte më shpesh për shkak të gjinisë.

Të anketuarat femra prireshin më shumë (N=54) të raportonin se ishin trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë krahasuar me të anketuarit meshkuj (N=12). Të anketuarit pensionistë (N=20) dhe ata të moshës mbi 65 vjeç (N=12) raportuan më shpesh se kategoritë e tjera se ishin trajtuar ndryshe për shkak të moshës. Edhe pse numri i të anketuarve që raportojnë diskriminim për shkak të orientimit të tyre seksual ishte shumë i ulët (N=10), është interesante të evidentohet se shumica e tyre jetonte në zonat rurale (N=7) sesa në zonat urbane (N=3).

Tabela 19. Trajtimi nga institucionet

Jam trajtuar ndryshe për shkak të:	16% (n = 258)
Gjinisë	4% (n = 67)
Moshës	4% (n = 66)
Përkatësisë etnike	3% (n = 43)
Orientimit seksual	1% (n = 10)
Aftësisë së kufizuar	1% (n = 20)
Tjetër *	3% (n = 52)
Nuk jam trajtuar ndryshe	84% (n = 1365)

*Tjetër: besimi politik, gjendja ekonomike (varfëria), apo paraqitja fizike.

Të anketuarit prireshin më shumë të raportonin se ishin trajtuar ndryshe nëse jetonin në zonat urbane (17%), ishin studentë (19%), të papunë (20%) apo të moshës nën 25 vjeç (23%). Gratë (19%) prireshin të raportonin më shumë se burrat (13%) se ishin trajtuar ndryshe. Nga 253 të anketuar që raportuan se ishin trajtuar ndryshe, 43% ishin burra dhe 57% gra.

Gratë në procesin e vendimmarrjes


Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e të anketuarve mendojnë se gratë janë po aq të afta sa burrat që kanë poste publike. Megjithatë, pavarësisht disa përpjekjeve për rritjen e përfaqësimit të grave në qeverisjen vendore, shumica e të anketuarve nuk e dinë nëse numri i grave në këshillin bashkiak është rritur.

Të anketuarit u pyetën për sa i përket përfaqësimit të grave në këshillin bashkiak. Gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2015 u zbatua një kërkesë e re për listat e kandidatëve me qëllim që të nxitet rritja e përfaqësimit të grave në qeverisjen vendore. Të gjitha listat për anëtarë të këshillit bashkiak duhet të përfshinin 50% të çdo gjinie, duke vendosur me radhë një emër kandidati mashkull dhe një emër femër, gjë që solli si rezultat 35% të anëtarëve të zgjedhur të këshillave vendorë të jenë gra (OSCE, 2015)²⁷.

Për të parë nëse të anketuarit kishin vënë re ndryshime në përfaqësimin e grave në qeverisjen vendore, ata u pyetën nëse kishin dijeni se ishte rritur numri i këshilltareve femra në këshillin bashkiak, krahasuar me numrin femrave në këshilli bashkiak para zgjedhjeve vendore të 2015. 20% e të anketuarve thanë "Po". 19% thanë se sot nuk ka më shumë gra në këshillat bashkiakë se para zgjedhjeve të 2015. 61% e të anketuarve nuk ishin të sigurt.

Përgjigjet varionin sipas gjinisë, statusit të punësimit dhe arsimit. Të anketuarit meshkuj (22%), të anketuarit që punojnë në sektorin publik (37%) dhe të anketuarit me nivel të lartë arsimiti (29%) prireshin më shumë të raportonin se në këshillin bashkiak ka më shumë gra se para zgjedhjeve vendore të 2015. Krahasuar me vitet e kaluara, të anketuarit u përgjigjën pothuajse njësoj, pra që një në pesë dhe një në katër të anketuar thonë se në këshillin bashkiak ka më shumë gra se para zgjedhjeve vendore të 2015.

Grafiku 69. A jeni në dijeni nëse Këshilli Bashkiak (ku ju banoni) ka më shumë gra?




Baza: 2016, N = 1635; 2017, N = 1628; 2018, N = 1632

.....

27 Shih raportin e OSBE-së për zgjedhjeve vendore në Shqipëri (shtator 2015). f. 25 <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/180731?download=true>

Më pas, në sondazh u bënë pyetje për aftësinë e grave në poste publike. 80% e të anketuarve thanë se “se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike”. 10% e të anketuarve besojnë se gratë nuk janë aq të afta sa burrat për të mbajtur poste publike dhe 10% nuk janë të sigurt nëse se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike. Krahasuar me 2016 dhe 2017, përqindja e të anketuarve që raportojnë se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike ka ndryshuar shumë pak. Në 2016 dhe 2017 83% e të anketuarve mendonin se gratë janë po aq të afta sa burrat për të mbajtur një post publik, ndërkohë që në 2018 80% u përgjigjën “ ‘Po, gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike’.

Grafiku 70. gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike




Baza: 2016, N = 1635; 2017, N = 1628; 2018, N = 1632

Nuk u vunë re dallime thelbësore për nga statusi i punësimit apo vendbanimi (urban përkundër rural). Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (74%) ose ata që kanë nivel të ulët arsimit (74%) janë më pak të prirur të thonë që gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike. Të anketuarit me më shumë vite arsimit (86%) dhe ata që punojnë në sektorin publik (86%) priren më shumë të raportojnë se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike.

Kur shohim dallimet në përgjigjet mes të anketuarve meshkuj dhe femra, shohim se gratë janë më shumë të prirura të raportojnë se gratë janë po aq të afta sa burrat për të mbajtur poste publike. 85% e të anketuarave femra thanë se gratë dhe burrat janë njësoj të aftë për poste publike, krahasuar me 74% të meshkujve.

Grafiku 71. A mendoni se burrat dhe gratë janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike?



Baza: N = 1632

Ndikimi i grave në qeverisjen vendore


Të dhënat e sondazhit tregojnë se shumica e shqiptarëve mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore.

Së fundi, të anketuarit u pyetën nëse besonin se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të kishte ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. 70% e tyre raportuan se gratë kanë ndikim pozitiv në vendimmarrjen vendore, ndërsa 12% e të anketuarve nuk mendonin kështu.

Gratë (78%) prireshin më shumë se burrat (62%) të mendonin se gratë kanë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. Po ashtu, të anketuarit me më shumë vite arsimi (74%) ishin më të prirur se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore, krahasuar me ata të anketuar që kanë shumë pak vite arsim (67%).

Është interesante të evidentohet se të anketuarit që punojnë në sektorin publik prireshin më shumë (76%) të raportonin se gratë mund të kenë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore se të anketuarit që punojnë në sektorin privat. Përgjigjet nuk ndryshonin shumë për nga mosha, vendbanimi apo statusi i punësimit.

Grafiku 72. A mendoni se një numër më i madh i grave në Këshillin bashkiak ka një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore?



Baza: 2016, N = 1635; 2017, N = 1631; 2018, N = 1633

Krahasuar me vitet e mëparshme, përqindja e të anketuarve që mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillin bashkiak do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore është rritur.

Lista e tabelave dhe grafikëve

Tabelat

Tabela 1. Grupmoshat	13
Tabela 2. Statusi i punësimit	14
Tabela 3. A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	16
Tabela 4. Besimi në institucione në vite (2013-2018)	21
Tabela 5. Tabelë e dykahshme “kam shumë besim” ose “kam besim”	24
Tabela 6. Besimi në institucione sipas madhësisë së bashkive	26
Tabela 7. Nisma për hapjen e dosjeve të ish Sigurimit të Shtetit 2017-2018	37
Tabela 8. Llogaridhënia 2015-2018	41
Tabela 9. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit 2017-2018	43
Tabela 10. Arsyet për pagesën e ryshfeteve 2018	48
Tabela 11. Perceptimi se “nuk ka aspak ndikim” ose “ka pak ndikim” i interesave politike 2016-2018	51
Tabela 12. Llojet e takimeve konsultuese ku kanë marrë pjesë	56
Tabela 13. Arsyet e mospjesëmarrjes në takimet e konsultimit	57
Tabela 14. Arsyet e pjesëmarrjes në demonstratë/tubim apo për nënshkrimin e një peticioni 2018	61
Tabela 15. Përdorimi dhe kënaqësia me shërbimet publike 2018	64
Tabela 16. Faktorët kryesorë që shkaktojnë ndjenjën e pasigurisë	71
Tabela 17. Performanca e institucioneve (në përqindje)	72
Tabela 18. Mënyrat e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë	77
Tabela 19. Trajtimi nga institucionet	86

Grafikët

Grafiku 1. Përfaqësimi sipas gjinisë	13
Grafiku 2. Niveli arsimor	14
Grafiku 3. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto)	15
Grafiku 4. Keni ndonjë aftësi të kufizuar?	15
Grafiku 5. Besimi në institucione 2018	19
Grafiku 6. Ndryshimi në besimin e përgjithshëm (p.p) 2017-2018	20
Grafiku 7. Besimi në institucione (degët e pushtetit) sipas grupmoshave 2018	22
Grafiku 8. Besimi në institucione (degët e pushtetit) sipas nivelit arsimor 2018	23

Grafiku 9. Besimi në institucione (degët e pushtetit) sipas statusit të punësimit 2018	23
Grafiku 10. Ndikimi pozitiv i reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit	27
Grafiku 11 Zbatimi i duhur i reformës në drejtësi	28
Grafiku 12. Cilën media përdorni më shumë?	29
Grafiku 13 A është i saktë/i vërtetë informacioni që jepet në media?	30
Grafiku 14. A do të donit të largoheni nga vendbanimi juaj aktual?	30
Grafiku 15. Transparenca e perceptuar e qeverisë qendrore dhe bashkive 2018	32
Grafiku 16. Ndryshimet në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2018	33
Grafiku 17. Transparenca e perceptuar e institucioneve dhe madhësia e bashkive	33
Grafiku 18. Sa në dijeni është publiku për Ligjin “Për të drejtën e informimit” në 2018	34
Grafiku 19. Kërkesat e bëra për informacion 2016-2018	35
Grafiku 20. Informacioni i kërkuar që është marrë 2016-2018	36
Grafiku 21. Nisma për hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit 2018	37
Grafiku 22. Llogaridhënia e perceptuar e qeverisë qendrore dhe bashkive 2018	38
Grafiku 23. Llogaridhënia e perceptuar dhe madhësia e bashkisë	38
Grafiku 24. Ndryshimet në llogaridhënien e perceptuar 2016-2018	39
Grafiku 25. Efektiviteti i perceptuar i mekanizmave të llogaridhënies horizontale 2018	40
Grafiku 26. Efektiviteti i perceptuar i mekanizmave të llogaridhënies vertikale 2018	40
Grafiku 28. Perceptimi për përhapjen e korrupsionit 2018	43
Grafiku 29. Perceptimi për ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit 2018	44
Grafiku 30. Përballja personale me rastet e korrupsionit 2018	45
Grafiku 31. Përballja personale me korrupsionin 2015-2018	45
Grafiku 32. Shërbimet e marra në nivel vendor	46
Grafiku 33. Ryshfeti i paguar në nivel vendor	46
Grafiku 34. Shërbimet e marra nga institucionet publike në nivel qendror	47
Grafiku 35. Ryshfeti i paguar në nivel qendror 2018	47
Grafiku 36. Përhapja e ryshfetit 2016-2018	48
Grafiku 37. Perceptimi i ndikimit të interesave politike në axhendën e institucioneve 2018	50
Grafiku 38. Interesi për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike 2018	52
Grafiku 39. Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes 2018	53
Grafiku 40. Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes 2016-2018	54
Grafiku 41. Ftesa për të marrë pjesë në proceset e konsultimit 2018	54
Grafiku 42. Ftesa për të marrë pjesë në proceset e konsultimit 2016-2018	55
Grafiku 43. Pjesëmarrje në takim konsultimi 2018	56

Grafiku 44. Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve	58
Grafiku 45. Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin e qytetarëve 2018	59
Grafiku 46. Pjesëmarrja në demonstratë/tubim apo nënshkrim peticioni 2018	60
Grafiku 47. Dëshira për t'u angazhuar në punë vullnetare 2018	61
Grafiku 48. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike 2018	63
Grafiku 49. Ndryshimet në cilësinë e shërbimeve sociale 2018	66
Grafiku 50. A keni paraqitur ndonjë ankesë tek institucionet e ofrimit të shërbimeve 2016 - 2018	67
Grafiku 51. A keni bërë ndonjë ankesë tek Platforma e Bashkëqeverisjes?	68
Grafiku 52. A u trajtua ankesa juaj? 2016-2018	69
Grafiku 53 . A mendoni se institucionet “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët?	69
Grafiku 54. Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme 2016 - 2018	70
Grafiku 55. Kënaqshmëria me ndikimin e asistencës së huaj (donatorët) në Shqipëri	74
Grafiku 56. A e dini nëse Bashkia juaj ka një faqe interneti?	75
Grafiku 57. A e dini nëse Bashkia juaj ka një faqe interneti? 2015-2018	76
Grafiku 58. A e përdorni faqen e internetit të bashkisë?	76
Grafiku 59. Cilësia e informacionit në faqen e internetit të bashkisë 2016-2018	78
Grafiku 60. A jeni në dijeni që qeveria (administrata) ofron shërbime elektronike përmes portalit E-Albania?	79
Grafiku 61. A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania?	79
Grafiku 62. Si do e vlerësonit cilësinë e shërbimeve elektronike të portalit e-Albania?	80
Grafiku 63. Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave	81
Grafiku 64. Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave 2016-2018	82
Grafiku 65. Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike	83
Grafiku 67. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave	84
Grafiku 68. Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave 2016-2018	85
Grafiku 69. A jeni në dijeni nëse Këshilli Bashkiak (ku ju banoni) ka më shumë gra?	87
Grafiku 70. gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike	88
Grafiku 71. A mendoni se burrat dhe gratë janë njësoj të aftë të mbajnë poste publike?	89
Grafiku 72. A mendoni se një numër më i madh i grave në Këshillin bashkiak ka një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore?	90

Bibliografia

Andvig, J. C., Fjeldstad, O. H., Weltzien, Å., Amundsen, I., Sissener, T. K., & Søreide, T. (2001). *Corruption. A review of contemporary research*. Bergen/Oslo, Norway: Chr. Michelsen Institute and Norwegian Institute of International Affairs.

Centre for Law and Democracy (2014). *Briefing Paper “International Standards on Transparency and Accountability”*. Retrieved at http://www.law-democracy.org/live/wp-content/uploads/2014/04/Transparency-and-Accountability.final_.Mar14.pdf

Dauti, M. (2017). *The impact of decentralization on participation in formal organizations in Albania: Lessons for community-based interventions*. *International Social Work*, 60(6), 1523-1536

Dauti, M. and Zhllima, E. (2016). *Public Perceptions and Attitudes toward Gender Equality in Albania*. Tirana, Albania: UNDP. Retrieved at http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/STUDIMI_PERCEPTIMET_eng.pdf

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. (2018). *Embracing Digitalisation: How to use ICT to strengthen Anti-Corruption*. Retrieved at <https://www.giz.de/en/worldwide/67145.html>

Eurostat. (29 August 2018). *Quality of life indicators*. Retrieved at https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Quality_of_life_indicators

Hetherington, M. J. (1998). *The Political Relevance of Political Trust*. *The American Political Science Review*, Vol. 92, No. 4, pp. 791-808.

Instat. (2018). *Women and Men in Albania 2018*. Retrieved at <http://www.instat.gov.al/media/4349/burra-dhe-gra-ne-shqiperi-2018.pdf>

Institute for Democracy and Mediation. (2010). *Civil society index for Albania: In search of citizens & impact*. Tirana, Albania: IDM.

Levi, M. and L. Stoker. (2000). *Political Trust and Trustworthiness*. *Annual Review of Political Science* 3: 475–507.

OECD. (2013). *Government at a glance 2013*. OECD Publishing.

OSCE. (2015). *Republic of Albania Local Elections 21 June 2015*. Retrieved at <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/180731?download=true>

Partners Albania. (2013). *Participation of citizens and civil society in decision making*. Tirana, Albania: Partners Albania

UN Women. (29 June 2018). For the first time in Albania, cities adopt Gender Equality Action Plans. Retrieved at <http://eca.unwomen.org/en/news/stories/2018/06/for-the-first-time-in-albania-cities-adopt-gender-equality-action-plans>

World Bank. (2012). Governance and Public Service Delivery in Europe and Central Asia: Unofficial Payments, Utilization and Satisfaction. Policy Research Working Paper 5994, pp. 2-3.

World Bank. (2012). Public office private interests: Accountability through Income and Asset Disclosure. Washington DC

Shtojca 1: Njësitë administrative

Nr.	Qarku	Qendra e bashkisë	Njësia administrative	Nr. i pyetësorëve
1	Berat	Berat	Otlak	27
		Ura Vajgurore	Poshnjë	27
		Kuçovë	Kozarë	27
		Skrapar	Qendër Skrapar	27
		Poliçan	Tërpan	27
2	Dibër	Peshkopi	Maqellarë	27
		Bulqizë	Ostren	27
		Burrel	Ulëz	27
		Klos	Xibër	27
3	Durrës	Durrës	Ishëm	27
		Shijak	Maminas	27
		Krujë	Fushë Krujë	27
4	Elbasan	Elbasan	Labinot	27
		Cërrik	Gostimë	27
		Belsh	Grekan	27
		Peqin	Përparim	27
		Gramsh	Pishaj	27
		Librazhd	Hotolisht	27
		Përrenjas	Qukës	27
5	Fier	Fier	Cakran	27
		Roskovec	Kuman	27
		Patos	Sharrëz	27
		Lushnjë	Golem	27
		Divjakë	Grabian	27
		Ballsh	Selitë	27
6	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Antigone	27
		Libohovë	Qendër Libohovë	27
		Memaliaj	Memaliaj Fshat	27
		Përmet	Petran	27
		Këlcyrë	Këlcyrë Fshat	27
		Tepelenë	Dukat	27
		Dropull i Sipërm	Dropull i Poshtëm	27

Nr.	Qarku	Qendra e bashkisë	Njësia administrative	Nr. i pyetësorëve
7	Korçë	Korçë	Vithkuq	27
		Maliq	Libonik	27
		Pustec	Pustec fshat	27
		Ersekë	Novoselë	27
		Bilisht	Hoçisht	27
		Pogradec	Udënisht	27
8	Kukës	Kukës	Bicaj	27
		Krumë	Golaj	27
		Bajram Curri	Margegaj	27
9	Lezhë	Lezhë	Shëngjin	27
		Rrëshen	Rubik	27
		Laç	Milot	27
10	Shkodër	Shkodër	Rrethinat	27
		Koplik	Gruemirë	27
		Pukë	Gjegjan	27
		Vau Dejës	Bushat	27
		Fushë Arrëz	Fierzë	27
11	Tiranë	Tiranë	Petrelë	27
		Kamëz	Paskuqan	27
		Vorë	Bërxullë	27
		Kavajë	Luz i vogël	27
		Rrogozhinë	Kryevidh	27
12	Vlorë	Vlorë	Orikum	27
		Selenicë	Vllahinë	27
		Himarë	Lukovë	27
		Sarandë	Ksamil	27
		Konispol	Xarrë	27
		Finiq	Livadhja	27

Shtojca 2: Karakteristikat e kampionit 2013-2018

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjinia						
Mashkull	45%	49%	50%	57%	51%	52%
Femër	55%	50%	50%	43%	49%	48%
Grupmosha						
18-25	14%	23%	23%	18%	19%	16%
26-35	14%	22%	25%	23%	23%	23%
36-45	14%	18%	16%	19%	19%	19%
46-55	19%	18%	17%	18%	19%	20%
55-65	20%	10%	11%	13%	11%	13%
Mbi 66	18%	7%	8%	9%	9%	9%
Niveli i arsimit të përfunduar						
Pa arsim + mbaruar shkollën fillore 4 vjeçare	1%	1%	2%	0%	5%	7%
Mbaruar shkollën 8/9 - vjeçare	14%	15%	14%	25%	17%	23%
Mbaruar shkollën e mesme	40%	41%	40%	51%	50%	46%
Me diplomë universitare/më lart	44%	42%	43%	24%	28%	24%
Statusi i punësimit						
I/E punësuar	40%	46%	45%	43%	46%	46%
I/E pa punësuar	20%	25%	28%	35%	34%	32%
Student	8%	10%	9%	8%	7%	6%
Pensionist	26%	9%	11%	12%	12%	12%
Tjetër	3%	5%	7%	2%	1%	4%

Shënim: Refuzimet nuk janë përfshirë. Përqindjet mund të mos përbëjnë totalin 100%.



sondazh i opinionit publik
2018
BESIMU NË QEVERISJE